



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Vorë

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

Bashkia Vorë

Tiranë, tetor 2025

| | |
|---|-----------|
| I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 4 |
| a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin..... | 4 |
| f. Paraqitja e gjetjeve kryesore..... | 5 |
| h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore | 6 |
| I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit..... | 6 |
| II. HYRJA | 7 |
| OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA. | 8 |
| 1. Objektivat dhe qëllimi..... | 8 |
| 2. Identifikimi i çështjes..... | 8 |
| 3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese..... | 8 |
| 4. Përgjegjësitë e audituesve | 9 |
| 5. Kriteret e vlerësimit. | 10 |
| 6. Standardet e auditimit..... | 10 |
| 7. Metodatat e auditimit..... | 11 |
| 8. Dokumentimi i auditimit..... | 12 |
| 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Vorë” | 12 |
| 2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit | 13 |
| 2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm. | 13 |
| 2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore..... | 28 |
| 2.3. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm | 45 |
| IV. REKOMANDIME..... | 65 |
| C. MASA DISIPLINORE | 68 |

Lista e shkurtimeve

| | |
|----------------|---|
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| MFK | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli |
| NA | Nëpunës Autorizues |
| NZ | Nëpunës Zbatues |
| GSM | Grupi i Menaxhimit Strategjik |
| NJAB | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| AB | Auditi i Brendshëm |
| MAB | Manuali i Auditimit të Brendshëm |
| FZHR | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| AQT | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara |
| UMF | Udhëzim i Ministrisë së Financave |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| ISSAI | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| INOTSAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit |
| ISA | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit |
| IFAC | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| IPSAS | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik |
| ASHK | Agjencia Shtetërore e Kadastrës |
| IT | Teknologjia e Infomacionit |
| NJA | Njësi Administrative |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vijim KLSH) ushtron auditim financiar në Bashkinë Vorë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Bashkia Vorë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatore.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Vorë për periudhën e aktivitetit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga KLSH, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente veprimtarinë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqënies së qytetarëve.

a. Për vitin 2024 nga Bashkia Vorë janë shpenzuar gjithsej 1,398,715 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 342,861 mijë lekë; për shpenzime operative dhe fond rezervë në vlerën 329,709 mijë lekë; transferata korrente për ndihmë ekonomike në vlerën 295,088 mijë lekë dhe për investime në vlerën 431,057 mijë lekë.

b. Për vitin 2024 Bashkia Vorë nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithsej vlerën 523,148 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50, pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”.

Auditimi i këtij institucioni merr rëndësi për arsye se administron, menaxhon dhe shpenzon, fonde të miratuar nga Këshilli Bashkiak Vorë, me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;

- Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve;

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 20,325 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik; Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese; Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; Kontrolli i vlerësimit; Konfirmim nga të tretët; Kontrolli sipas një treguesi; Verifikimi i transaksioneve; Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se Bashkia Vorë për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 7 gjetje dhe ka dhënë 7 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh për taksat dhe tarifat vendore, ku në fund të vitit 2023 vlera e debitorëve është 302,825 mijë lekë, shtesat gjatë vitit 2024 janë në shumën 423,203 mijë lekë. Detyrimet progresive në fund të vitit 2024 janë në shumën 726,028 mijë lekë, e cila përbëhet nga:

- Detyrimet debitorë nga biznesit i madh dhe i vogël në shumën 332,943 mijë lekë.

- Detyrimet debitorë nga familjarët në shumën 393,085 mijë lekë.

- Nga auditimi rezultoi se amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale paraqitet në bilanc me vlerën 237,904 mijë lekë, e cila përputhet me pasqyrën e amortizimit të bilancit, por nga shqyrtimi i tij u konstatua se llogaritja e amortizimit është kryer në mënyrë të grupuar sipas natyrës së aktiveve dhe jo në mënyrë individuale për secilin aktiv, duke bërë të pamundur identifikimin dhe vlerësimin e vlerës neto kontabël të çdo aktivi në mënyrë individuale, duke kufizuar transparencën, besueshmërinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave financiare. Kjo mënyrë e llogaritjes së amortizimit nuk është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme”, pika 36”.

- Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të vitit 2024, gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet me vlerë 0 lekë. Nga shqyrtimi u konstatua se në këtë llogari nuk është pasqyruar pjesëmarrja e Bashkisë Vorë, si ortak i vetëm i K. F. V. SH.A., në vlerën 2,000 mijë

lekë. Mosregjistrimi i kësaj vlere cënon saktësinë dhe plotësinë e pasqyrimit të aktiveve financiare dhe të fondit bazë të institucionit.

Veprime në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, pika 31, gërma a, në momentin fillestar të pjesëmarrjes me kapital, njësi të qeverisjes së përgjithshme duhet të kryejnë regjistrimin kontabël përkatës duke debituar llogarinë 26 “Pjesëmarrja me kapitalin e vet” dhe kredituar llogarinë 1011 “Shtesa të fondit bazë”.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave, të analizojnë situatën debitore dhe të hartojnë një plan masash periodike dhe vjetor për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB për të parandaluar krijimin e debitorëve të rinj.

Të merren masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, masat shtrënguese dhe bllokimet e llogarive, për rritjen e arkëtimeve të debitorëve me qëllim minimizimin e vlerës progresive të debisë prej 797,628 mijë lekë.

-Nëpunësi Zbatues të sigurojë që llogaritja e amortizimit të kryhet në mënyrë individuale për çdo aktiv afatgjatë si dhe të përmirësohet evidenca kontabël e aktiveve në mënyrë që në pasqyrat financiare të jetë e qartë dhe e verifikueshme vlera neto kontabël e secilit aktiv, duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e informacionit financiar.

- Kryetari i Bashkisë Vorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa që pjesëmarrja e Bashkisë Vorë në kapitalin e K. F. V. SH.A, në vlerën 2,000 mijë lekë, të pasqyrohet saktësisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, duke reflektuar në mënyrë të besueshme dhe transparente pozicionin financiar të njësisë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:

a. Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes¹

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Vorë për vitin ushtrimor 2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese, si dhe të gjitha pasqyrat statistikore që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare të Bashkisë Vorë paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në datën 31.12.2024, por

¹ Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar“, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.54), Kapitulli VII pika 4.1. Një opinion me “Theksim Çështjeje”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, shprehur në bazën e opinionit, të cilat në gjykimin e audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një **opinionit të pamodifikuar me theksim të çështjes**.

Baza për opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes:

Ne kemi kryer auditimin financiar në mbështetje me Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s) mbështetur në ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar”, ISSAI 2000 “Aplikimi i standardeve të auditimit financiar”, në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, të miratuar me Vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217 datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, si dhe kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale, në bazë të materialitetit të llogaritur në vlerën 20,325 mijë lekë.

Theksimi i çështjeve:

-Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale paraqitet në bilanc me vlerën 237,904 mijë lekë, e cila përputhet me pasqyrën e amortizimit të bilancit, por u konstatua se llogaritja e amortizimit është kryer në mënyrë të grupuar sipas natyrës së aktiveve dhe jo në mënyrë individuale për secilin aktiv, duke bërë të pamundur identifikimin dhe vlerësimin e vlerës neto kontabël të çdo aktivi.

-Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, u konstatua se në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 është paraqitur në vlerën 168,208 mijë lekë, ndërsa në mbyllje të vitit 2023 ka qenë 363,290 mijë lekë, me një ulje prej 195,083 mijë lekë, e cila reflekton shlyerjen e një pjese të detyrimeve ndaj kreditorëve të ndryshëm. Në këtë llogari janë shtuar vlera të mbartura që datojnë që nga viti 2006, të cilat fillimisht ishin regjistruar në llogaritë 401- 408 “Furnitorë të ndryshëm” dhe i përkasin furnizimeve të vjetra apo diferencave në faturim.

-Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të vitit 2024, u konstatua se gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet me vlerë 0 lekë. Në këtë llogari nuk është pasqyruar pjesëmarrja e Bashkisë Vorë, si ortak i vetëm i K. F. V. SH.A., në shumën 2,000 mijë lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 736/1prot., datë 03.07.2025 “*Auditim financiar në Bashkinë Vorë*”, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.07.2025- 30.07.2025, në subjektin Bashkia Vorë për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 - 31.12.2024, u krye “*Auditim Financiar*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. M. V. Përgjegjës Grupi,
2. K. F. anëtar;
3. B. P. anëtar;
4. A. G. anëtar;
5. K. G. anëtar;
6. L. Ç. anëtar.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Raporti përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Vorë.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Vorë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë më të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Vorë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Vorë (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë

Vorë, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar në aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.²

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Vorë në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Vorë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

² Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit.

Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”;

- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”;

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “*Për përgatitjen e buxhetit vendor*”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

- Në fushën e mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar;

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave lokale*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008, “*Për taksat kombëtare*”, i ndryshuar;

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “*Për pagat e vetëqeverisjes Vendore*”, i ndryshuar.

- Në fushën e administrimit e pronës publike: Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”, VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave të Bashkisë*”.

6. Standardet e auditimit.

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Vorë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”; ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”; INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”; INTOSAI “*Për*

*implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*³ etj; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampionëve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*³. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërive ose të çdo regjistrimi tjetër.

³ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
 - *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
 - *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
 - *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Me shkresën nr. 736/2, datë 11.09.2025, nga grupi i auditimit të KLSH është nisur Projektraporti i Auditimit në të cilën u evidentuan mangësitë e konstatuara gjatë procesit të auditimit, mangësi të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjor gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

Nga ana e Bashkisë Vorë nuk janë paraqitur kundërshtimet në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit. Nga ana e grupit të auditimit është vijuar me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Vorë”

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim. Bashkia Vorë shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me Bashkinë Krujë, në lindje me Bashkinë Kamëz, në jug me Bashkinë Tiranë, në jug-perëndim me Bashkinë Shijak. Sipas të dhënave demografike të Censurit, më datë 18 shtator 2023, numri i banorëve në territorin e Bashkisë Vorë është 21,621 banorë. Me shpërndarje të popullsisë sipas gjinisë në 49.6% meshkuj dhe 50.4% femra.

Buxheti i Bashkisë Vorë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit

për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara.

Bashkia siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë;

b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;

c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;

ç) ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Vorë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Vorë për periudhën e aktivitetit të vitit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;

2. Kod i Etikës;

3. Struktura organike e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;

4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;

5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;

6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;

7. Strategjia dhe Regjistri i Riskut;

8. Lista ose harta e proceseve të punës;

9. Raportet e Monitorimit;

10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe dërgimi në Ministrinë e Financave.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK;
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/Komunikimi, si dhe Monitorimi;
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Vorë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Aktivitetet e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi si dhe Monitorimi, sipas përcaktimit të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 19 ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2024, rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Parimi 1 -“Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Vorë në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Urdhrin nr. 214, datë 01.12.2022, administruar me nr. 6910 prot., datë 01.12.2022 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative”. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

-Kodi i Etikës është miratuar me Vendimin nr. 235, datë 30.12.2022, administruar me nr. 7555 prot., datë 30.12.2022 në mbështetje të Ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik. Rregullorja e Brendshme dhe Kodi i Etikës janë të afishuara në faqen zyrtare të Bashkisë.

- Me shkresën nr. 6213/1 prot datë 20.11.2023, drejtuar ASPA, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar evidenca “Vlerësimi i nevojave për trajnim për vitin 2024” për punonjësit e Bashkisë Vorë.

- Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.

- Me shkresën nr. 1154 prot., datë 13.08.2018 është miratuar “Rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Vorë”.

- Me shkresën nr. 431 prot., datë 26.11.2021 është miratuar “Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja”.

- Për vitin 2024 raportimi në ILDKPKI për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve është bërë nëpërmjet email zyrtar.
- Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore, bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.
- Bëhen dy vlerësime gjatë vitit kalendarik, vetëm për nëpunësit civil në periudhë prove vlerësimi është një vjeçar në përfundim të periudhës së provës, ndërsa për punonjësit me kod pune bëhet vlerësim 1-vjeçar.
- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Informimit/Drejtoria e Marrëdhënive me Publikun dhe Integritit të Politikave të BE-së), duke iu adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

Parimi 2-“Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Për vitin 2024, situata paraqitet pjesërisht efektive, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga një pjesë e drejtorive, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.

- Bashkia Vorë ka hartuar raporte monitorimi periodike dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si edhe në Ministrinë e Financave (MF).

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.

- Nëpërmjet shkresës nr. 1405/1 prot., datë 17.03.2024 është dërguar pranë MF-së “Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”, “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon”, për vitin e mëparshëm.

- Bashkia Vorë është aksionere me kuota 100% e shoqërisë “K. F. V.” SH.A. e krijuar më datë 10.09.2009. Nga dokumentacioni i administruar, konstatohet se janë realizuar raportime zyrtare përgjatë vitit 2024 mbi performancën e shoqërisë në lidhje me treguesit financiar dhe ushtrimin e veprimtarisë.

- Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrësi i qeverisjes bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë.

Parimi 3 - “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiwe funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Institucioni vepron mbi bazën e rregullores së brendshme të miratuar me Vendimin nr. 214, datë 01.12.2022, nr. 6910 prot., “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative” e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë.

- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, por këto nuk janë përfshirë as në rregulloren e brendshme.

- Bashkia Vorë ka të hartuar dhe miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor nr. 23, datë 28.02.2019.

- Me Vendimin nr. 120, datë 30.11.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vorë dhe njësive administrative Prezë dhe Bërxull, për vitin 2024” është miratuar struktura e përbërë nga 487 punonjës, ndër të cilët 124 nëpunës civilë.

- Struktura organizative e Bashkisë

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

Funksionet politike: Kryetari, Zëvendëskryetarët, Administratoret, Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.

Nëpunësit civil: Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

a. Nëpunës të nivelit të lartë drejtues: Sekretari i Përgjithshëm.

b. Nëpunës të nivelit të mesëm drejtues: Drejtorë Drejtorie

c. Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: Përgjegjës Sektori

d. Nëpunës të nivelit ekzekutiv: Specialistët.

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Tabela nr. 1. Struktura e Bashkisë Vorë për vitin 2024

| | | | |
|--|------------|---------------------|------------|
| | | Nëpunës Civilë | 124 |
| Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar | 487 | Nëpunës me kontratë | 363 |
| Numri i të punësuarve me kontratë provizore | | Jo | - |
| Vende vakante | | Po | 61 |

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bashkia Vorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Përgjatë vitit 2024, janë rekrutuar **15** punonjës të rinj dhe janë larguar **23** punonjës. Dosjet e personelit përgjithësisht janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, përveç disa rasteve për punonjësit e punësuar me kod pune ku nuk administrohet rregullisht vlerësimi periodik 1 vjeçar, jo sipas përcaktimeve të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II. “Dosja e Personelit”.

-Bashkia Vorë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

Parimi 4 – “Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave”

- Stafu administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshme ofruar nga ASPA, pjesë e procedurës për përfitim të statusit të nëpunësit civil. Nga auditimi rezultoi se nga Bashkia Vorë, konkretisht struktura përgjegjëse e saj, Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Në materialet dërguar grupit të auditimit të KLSH konstatohen dokumente që vërtetojnë trajnimin e punonjësve nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ndërkaq Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1 parashikon se vetë institucioni duhet të organizojë trajnime të brendshme për stafin.

- Trajnimet realizohen nga ASPA dhe punonjësit i përzgjedhin vetë temat për të cilat kanë interes. Hartimi i planeve vjetore të trajnimeve mundëson një trajnim efektiv të personelit në përputhje me pozicionin në strukturë. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësive kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

-Për Bashkinë Vorë, Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

-Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar.

- Me Urdhrin nr. 175 datë 20.03.2024, titullari ka emëruar në rolin e Koordinatorës së MFK, znj. A. B. me detyrë Specialiste Risku në Sektorin e monitorimit dhe zbatimit të buxhetit.

- Me Vendimin nr. 1477, datë 20.03.2024, titullari i Bashkisë Vorë ka krijuar ekipin e koordinatorëve të riskut për çdo nivel drejtimi.

- Është hartuar Plani vjetor i rekrutimeve me shkresën nr. 550 prot, datë 26.01.2024, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vorë.

- Për vitin 2024 janë kryer trajnime nga ASPA, ku kanë marrë pjesë 14 nëpunës të institucionit.

- Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të Ligjit 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

Parimi 5 - “Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësisë dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi i kryer rezultoi se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe ka autorizime për delegimin e detyrave.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

-Për vitin 2024, me shkresën nr. 1696 prot., datë 02.04.2024, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 123, datë 02.04.2024 “Për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe Ekipetë të Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”. Në

këtë urdhër, komisioni ka në përbërje 24 anëtarë sipas sektorëve dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se në vitin 2024 janë mbajtur 3 takime (nr. 01 datë 14.11.2024, nr. 2, datë 18.11.2024, nr. 3, datë 19.11.2024, 18.11.2024), dokumentuar me procesverbal, nga 4 takime që duhet të zhvilloheshin në mënyrë periodike sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar neni 8, 12 dhe 27; “Manuali MFK” Kreu II kap. 2.2.6;

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 - “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva”

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët/NA/Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitetet, raportimet dhe pajtueshmërinë.

- Nga auditimi i kryer konstatohet se Bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2025-2027 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 69 datë 22.12.2023 “*Për miratimin e Programit Buxhetor për vitin 2024*”. Ky dokument është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë.

Parimi 7 - “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”

-Nga Bashkia Vorë është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, me aktin nr. 4034/1 prot. datë 12.07.2024 në përputhje me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, si dhe Udhëzimi nr. 16 dt. 20.07.2016.

- Me Urdhrin nr. 160 prot., datë 12.07.2024, administruar me shkresë nr. 4034 prot, datë 12.07.2024, Kryetari i Bashkisë Vorë ka miratuar regjistrin e riskut.

- Nga auditimi rezulton se janë miratuar gjurmët standarde të auditimit me shkresën nr.669/1 prot., datë 02.02.2024.

Parimi 8 - “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve”

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrin të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

- Me urdhrin nr. 669, datë 02.02.2024, është miratuar “Manuali i menaxhimit të rrezikut të mashtrimit dhe promovimit të integritetit Bashkia Vorë”.

- Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi.

Parimi 9 - “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme”

-Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Vorë ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 - “Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit”

-Në vijim të auditimit të kryer, konstatohet se janë hartuar hartat e procesve të punës për secilën drejtori/sector, por nuk janë përcaktuar afatet konkrete për realizimin e tyre, për ato procese pune kur është e mundur vendosja e afatit të realizimit të tyre.

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.

-Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Përgjegjësi i Buxhetit. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Specialisti i financës për kontabilizimin dhe autorizimi i pagesës nga Drejtori i Financës.

-Në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bashkia i ka të qarta procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.)

-Në zbatim të Udhëzimit nr. 01, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP... dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

-Bashkia Vorë ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuarat si për shtesat dhe pakësimet.

-Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AFMIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Vorë.

-Bashkia Vorë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga bashkia.

Parimi 11 - “Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë”

- Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS etj) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up.

- Institucioni përdor edhe sisteme të tjera të IT-së si E-Lejet, sistemin e pagesave me thesarin, sistemin e strehimit.

- Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces.

- Bashkia Vorë ka një server për menaxhimin e sistemit të taksave të shtrirë edhe në njësitë administrative.

- Nuk ka rregullore për sigurinë e informacionit.

-Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Parimi 12 - “Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

-Bashkia i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

-Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se Bashkia Vorë ka miratuar gjurmën e auditimit me shkresën nr. 669/1 prot., datë 02.02.2024, për proceset kryesore të punës, si zbatimimi i buxhetit, për

prokurimet, për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në Bashkinë Vorë etj.

- Nga auditimi rezultoi se, Plani vjetor i punës së Drejtorisë së menaxhimit financiar për vitin 2024, është miratuar me shkresën nr. 01 prot, datë 03.01.2024.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar.

IV. Komponenti “Informimi dhe komunikimi”

Parimi 13 - “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor”

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit, për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

- Institucioni ka dhe sisteme të tjera të IT-së E-Lejet, Tais, Sistemin e pagesave me thesarin dhe instrumentin e planifikimit financiar. Detyrat dhe kompetencat e Sektorit të Teknologjisë dhe Inovacionit, janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të institucionit, por nuk është miratuar një rregullore e brendshme IT.

- Masat të cilat janë marrë janë ngritja e firwall, ndryshimet e paswërdeve në mënyrë periodike në aksesin e pajisjeve kritike IT (Modem, Ruter, Switch servera etj).

- Për sa i përket rregullave për ruajtjen nga dëmtimet fizike janë të përcaktuara në rregullat dhe përcaktimet teknike të servisit dhe IT.

- Institucioni nuk ka një sistem rezerve të përshtatshëm, plan rikuperimi nga fatkeqësitë.

Parimi 14 - “Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm”

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit, për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas programeve dhe projekteve. Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalet e mbledhjeve u komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.

-Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - “Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm”

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit. Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të njësisë të informacionit lidhur me veprimtarinë e saj dhe realizimin e objektivave vjetore dhe strategjive. Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

V. Komponenti “Monitorimi”

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - “Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm”

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

-Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme nuk monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike.

-Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së, shkresa nr. 1619 prot, datë 28.03.2024.

-Bashkia Vorë monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 1405/1 prot., datë 17.03.2024 në Drejtorinë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MF-së.

-Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm.

-Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

-NJAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2024.

Parimi 17 - “Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, për periudhën objekt auditimi është konstatuar mungesa e planit vjetor të trajnimeve të detyrueshme për punonjësit dhe programe të trajnimit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës, për punonjësit e punësuar me kod pune ku nuk administrohet rregullisht vlerësimi periodik 1 vjeçar, nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, nuk janë miratuar manualat e proceseve të punës, nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse, nuk është miratuar një rregullore e brendshme IT, nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up-it, nuk ka rregullore për sigurinë e informacionit, plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Mangësitë më sipër nuk janë konform përcaktimeve ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm konkretisht Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, Kreu II, neni 8, pika c, Kreu III, neni 20, neni 22, pika 1; neni 23, neni 24, “Monitorimi” pika 1;

- “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.1, 3.3, 3.4, Kapitulli V, Anekset.

-Ligji 114/2015 datë 22.10.2015 “*Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*” i ndryshuar, nenin 12, 13 dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit*”.

-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, Kreu II- “Dosja e Personelit”;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”, pika 2.2.1, a, b, c, d, pika 2.3.1, pika 5.2.7.

Personat përgjegjës, janë znj. A. D., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për vitin 2024 e në vazhdim; znj. A. B., në cilësinë e Kordinatorës së riskut emëruar me Urdhrin me nr. 175 të datës 20.03.2024; znj. M. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Auditi i Brendshëm

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të institucionit;
- Karta e Auditimit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm (NjAB);
- Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
- Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2024;

- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
- Dosjet e subjekteve të audituara;
- Projekt Raportet dhe Raportet Përfundimtare të realizuara nga NjAB;
- Raport mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm;

Organizimi dhe funksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Në Bashkinë Vorë, Njësia e Auditit të Brendshëm është ngritur në bazë të VKM-së nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar dhe është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Vorë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

Struktura organizative e NjAB

Sektorin e Auditit të Brendshëm Financiar në Bashkinë Vorë është miratuar dhe ka funksionuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 120, datë 30.11.2023, nr. 6604 prot., “Mbi miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësive administrative Prezë dhe Bërxull për vitin 2024”, në të cilin përcaktohet se ky sektor do të përbëhet nga 4 punonjës, konkretisht 1 (një) përgjegjës dhe 3 (tre) specialistë. Konstatohet se për vitin 2024, kjo strukturë ka vepruar vetëm me 2 (dy) punonjës në pozicionin specialistë. Pra, struktura e sektorit ka qenë e paplotësuar, si rrjedhojë e mos pasjes së një përgjegjësi për gjatë gjithë vitit, si dhe të një specialisti tjetër, veprim në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik, pika 3 dhe me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10.

Përsa i takon 2 (dy) specialistëve të NjAB gjatë vitit 2023, kanë qenë znj. V. A. e emëruar në këtë pozicion nga data 10.08.2020, bazuar në Vendimin nr. 187, nr. 6398 prot., datë 11.08.2020, e pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm, si dhe znj. L. M. e emëruar në këtë pozicion nga data 07.01.2022, bazuar në Urdhrin nr. 08, datë 06.01.2022, nr. 79 prot., “Për zbatim akt emërimi”, e pajisur me certifikatë të audituesit të brendshëm. Përbërja e sektorit NjAB, për vitin objekt auditimi paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2. Struktura e DAB për vitin 2024

| Nr | Emër Mbiemër | Pozicioni | Fillimi i punës në NJAB | Certifikuar si specialist në NJAB | Orë trajnimi të vijueshëm gjatë vitit | Ekperiencë pune në AJ apo AB përpara certifikimit si AB (për personat e pacertifikuar, eksperiencia aktuale) | Ekperiencë pune në NJAB pas certifikimit |
|----|--------------|-------------|-------------------------|-----------------------------------|---------------------------------------|--|--|
| 1 | V. A. | Specialiste | 10.08.2020 | 2023 | 40 | 3 vjet | 2 vjet |
| 2 | L. M. | Specialiste | 07.01.2022 | 2008 | 40 | - | 3 vjet |

Burimi: Sektorin e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Vorë

Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Konstatohet se Bashkia Vorë nuk ka ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm, veprim në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion Karta e Auditimit të Brendshëm përgatitur nga Njësia e Auditit të Brendshëm dhe miratuar nga titullari i Bashkisë Vorë me shkresën nr. 1617 prot., datë 27.03.2024, kjo në zbatim të kërkesave të nenit 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe në përputhje me kërkesat e pikës 2.6.1, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016.

Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve

Plani strategjik dhe vjetor është një dokument që përgatitet nga Sektori i Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publike dhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm si edhe pas identifikimit dhe vlerësimit të riskut brenda njësisë publike. Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik 2024-2026. Plani Strategjik dhe vjetor për vitin 2024 është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, për vitet 2024-2026, me shkresën nr. 5084/1 prot., datë 18.10.2023, miratuar me urdhrin nr. 108 datë 18.10.2023. Plani strategjik dhe vjetor përgjithësisht është hartuar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3.

Hartimi i planeve të auditimit, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara.

Plani Vjetor i Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është miratuar me Urdhrin nr. 108 datë 18.10.2023. Bazuar në tabelën nr. 3, për vitin 2024 janë planifikuar të kryhen 4 (katër) angazhime auditimi të kombinuara si vijon:

Tabela nr. 3. Planifikimi dhe realizimi i auditimeve AB 2024

| Nr. | Auditime të Planifikuara | Auditime të realizuara | Rekomandime | Zbatuar | Proces | Zbatuar Pjesërisht | Pa zbatuar |
|-------------|--|-------------------------------|--------------------|----------------|---------------|---------------------------|-------------------|
| I. | Dr. e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit | Po | 3 | - | 3 | - | - |
| II. | Dr. e Menaxhimit Minanciar dhe Programeve të Strehimit | Po | 6 | - | 6 | - | - |
| III. | Dr. e Mirëmbajtjes dhe Mbikqyrjes së Infrastrukturës së Territorit | Po | 10 | 1 | 6 | - | 3 |
| IV. | Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve | Po | | | | | |
| | Gjithsej | 4 | 19 | 1 | 15 | - | 3 |

Burimi: Sektori i Auditimit të Brendshëm, Bashkia Vorë

Referuar planit vjetor, gjatë vitit 2024 janë evaduar gjithsej 4 raporte auditimi, prej të cilave 3 drejtori të Bashkisë dhe një raport mbi zbatimin e rekomandimeve.

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të këtij auditimi, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Grupit të auditimit iu vendos në dispozicion Vendimi nr. 73 datë 27.05.2022 “Për programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Bashkinë Vorë” dhe Vendimi nr. 22 datë 04.02.2025, por jo programi për vitin 2024.

Raportimi vjetor në drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të brendshëm në MFE

Për aktivitetin e NjAB për vitin 2024 është dërguar raporti vjetor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF me shkresën nr. 333/1 prot., datë 13.02.2025 brenda afatit kohor të përcaktuar në Manualin e AB. Dokumentacioni është shoqëruar edhe me pjesën përshkuese të raportit, i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Pika 3.6.

-Me shkresën nr. 468/4 prot., datë 26.03.2025 është dërguar raporti vjetor mbi zbatimin e rekomandimeve për vitin 2024.

Bazuar në raportin e zbatimit të rekomandimeve 2024, gjithsej 19 është konstatuar statusi i zbatimit të tyre si në vijim:

- Zbatuar 1 rekomandim ose 5.3%;
- Në proces zbatimi 15 rekomandime ose 79%;
- Pa zbatuar 3 rekomandime ose 15.8%

Në raportin për zbatimin e rekomandimeve nuk është plotësuar tabela nr. 1 dhe 2 siç parashikohet në udhëzimin nr. 42 datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, pika 14 ku citohet “Për angazhimet e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve njësitë e auditimit të brendshëm plotësojnë Pasqyrën nr.2 bashkëlidhur këtij Udhëzimi.” Dhe kapitulli IV “Raporti Vjetor i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm duhet të përmbajë: b. Pasqyrën “Rekomandime sipas kategorive” sipas kërkesave të përcaktuara në Pasqyrën nr. 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi. c. Pasqyrën “Raportimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm” sipas kërkesave të përcaktuara në Pasqyrën 2, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.”

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumenteve nëse veprimtaria e auditimit të brendshëm në Bashkinë Vorë është në përputhje me standartet dhe procedurat si edhe për të verifikuar nëse këto dosje janë përgatitur për çdo angazhim auditimi dhe janë respektuar të gjitha proceset për realizimin e angazhimit në përputhje me bazën ligjore është përzgjedhur një kampion për testim prej 2 dosje, pra 50% të total të auditimeve të kryera gjatë vitit 2024 si më poshtë:

- dosja e auditimit të kryer në “Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimi të Territorit”
- dosja e auditimit të kryer në “Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programit të Strehimit”

Janë plotësuar të dyja dosjet në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm autorizimet (formati standard 1), deklaratat e konfliktit të interes (formati standard 2).

Nga auditimi është konstatuar se nuk janë zbatuar me rigorozitet afatet procedurale në zbatimin e auditimit, konkretisht afati 10 ditor i njoftimit me takimin fillestar.

Auditimi i ushtruar në “Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimi të Territorit (DPKZHT)”

Me shkresën nr. 1170 prot., datë 04.03.2024 është hartuar autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim. Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit është hartuar me shkresën nr. 1170/1 prot., datë 04.03.2024, takimi fillestar me shkresën pa numër, datë 09.03.2024, nuk është respektuar afati **10 ditë pune** siç parashikohet në pikën 4.1.4. Hapi 3: Takimi fillestar me organizatën (njësinë publik) të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me urdhrin nr. 100 datë 25.10.2016 ku citohet “Drejtuesi i NjAB si rregull, duhet të njoftojë njësinë publike 10 ditë pune përpara takimit fillestar, për përfshirjen në bashkëpunim dhe komunikim të plotë midis njësisë dhe grupit të auditimit...”

Me shkresën nr. 1170/2 prot., datë 18.03.2024 është miratuar programi i auditimit të përputhshmërisë në DPKZHT.

Me shkresën pa numër prot., datë 24.05.2024 është hartuar procesverbali mbi takimin përfundimtar për përmbylljen e auditimit në terren.

Me shkresën nr. 1170/3 prot., datë 30.05.2024 është dërguar projekt raporti i auditimit, në përputhje me afatin procedural 10 ditë pune nga përmbyllja e fazës së terrenit sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm, pika 4.1.12. “Hapi 11: Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar.”

Lidhur me këtë auditim nuk janë paraqitur observacione.

Me shkresën nr. 1170/4 prot., datë 13.06.2024 është dërguar raporti përfundimtar për auditimin e kryer, duke respektuar afatin procedural 10 ditë pune.

Me shkresën nr. 3641 prot., datë 03.07.2024 DPKZHT ka dërguar plan veprimin lidhur me rekomandimet e lëna.

Me shkresën nr. 1170/6 prot., datë 17.06.2024 është hartuar memo për kryetarin e Bashkisë lidhur me auditimin e kryer.

Auditimi i ushtruar në “Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit”

Me shkresën nr. 3604 prot., datë 02.07.2024 është hartuar autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim. Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit është hartuar me shkresën nr. 3604/1 prot., datë 03.07.2024, takimi fillestar me shkresën pa numër, datë 10.07.2024, nuk është respektuar afati **10 ditë pune** siç parashikohet në pikën 4.1.4. Hapi 3: Takimi fillestar me organizatën (njësinë publik) të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me urdhrin nr. 100 datë 25.10.2016 ku citohet “Drejtuesi i NjAB si rregull, duhet të njoftojë njësinë publike 10 ditë pune përpara takimit fillestar, për përfshirjen në bashkëpunim dhe komunikim të plotë midis njësisë dhe grupit të auditimit...”

Me shkresën nr. 4074 prot., datë 15.07.2024 është miratuar Program-Auditimi i kombinuar në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit.

Me procesverbalin datë 06.09.2024 është mbajtur takimi përfundimtar për përmbylljen e auditimit në terren. Me shkresën nr. 4074/1 prot., datë 11.09.2024 është dërguar projekt raporti i auditimit. Lidhur me këtë auditim nuk janë paraqitur observacione.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është dërguar me shkresën nr. Prot 4074/2, datë 16.09.2024 duke respektuar afatet procedurale 10 ditë pune.

Me shkresën nr. 28 prot., datë 22.10.2024 nga njësia e audituar është dërguar Plan- Veprimi pranë sektorit të Auditimit të Brendëshëm.

Me shkresën nr. Prot 4074/3 datë 20.09.2024 është hartuar memo për Kryetarin e Bashkisë lidhur me auditimin e kryer.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Vorë, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 736/2 prot., datë 11.09.2025.

2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore

- Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar, shënimeve shpjeguese dhe pasqyrat statistikore.

- Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme.

- Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta/transfertat dhe mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat financiare të vitit 2024 të shoqëruar me formatet 1-9;
- Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues;
- Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve, libri i aktiveve;
- Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur;
- Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Vorë në mbyllje të vitit buxhetor;
- Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme në programet “exel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet të ardhurat etj).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

• Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2024

Në fund të periudhës ushtrimore, bilanci është plotësuar sipas formateve standarde të miratuara me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022.

• Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.

Bashkia Vorë për vitin 2024 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi nuk ka në varësi njësi shpenzuese me NIPT më vete.

• Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Tiranë për vitin ushtrimor 2024 me shkresë përcjellëse nr. 1599 prot.4824, datë 28.03.2025. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Vorë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

• Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrati banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për t'u siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit të Bashkisë.**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel" dhe manual.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose

administrative. Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si, me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtyre dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar për vitet 2023 dhe 2024.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruara në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës.

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha aktivet dhe fondet e veta janë regjistruar dhe detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilancin e vitit ushtrimor 2024.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin nr. 5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2024”.

Totali i Aktivit për vitin 2024 është në vlerën 6,067,144 mijë lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari sintetike dhe analitike paraqitet në Aneksin 1/1 bashkëlidhur PRA.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatshkurtra”, në aktiv të bilancit paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,368,412 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,082,257 mijë lekë.

- **Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”**, në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 324,241 mijë lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “ Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr. 3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW)

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 324,241 mijë lekë, gjëndje e cila rakordon me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr. 5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2024”, e paraqitur në Aneksin 1/2.

- **Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues”**, të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 28,141 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 20,994 mijë lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej 7,147 mijë lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”**, paraqitet paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 10,007 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,943 mijë lekë, me një diferencë për vitin ushtrimor prej 4,064 mijë lekë, e cila përfaqëson rritje të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët”**, paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 18,134 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 15,051 mijë lekë, me një diferencë për vitin ushtrimor prej 3,083 mijë lekë, e cila përfaqëson rritje të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2024.

- **Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”**, paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 847,822 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 346,799 mijë lekë, ku kemi shtesë duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes së detyrimeve të debitorëve të ndryshëm.

- **Gjendja e llogarisë 437, 438 “Organizma të tjerë shtetërore”**, në aktiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë.

Konstatim: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 797,628 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 302,825 mijë lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 ka pësuar një rritje prej 494,803 mijë lekë. Rritja e konsiderueshme e gjendjes së debitorëve është ndikuar nga verifikimi i dosjeve fizike të të gjitha subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Vorë, proces i cili është realizuar në zbatim të Urdhrit të Kryetarit nr. 30, datë 24.02.2024, 'Për regjistrimin në kontabilitet të listës së debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore', si dhe regjistrimi përkatës në sistemin e taksave 'Coin Master'."

▪ Gjendja e debitorëve më datë 31.12.2024

Nga përpunimi i të dhënave nga informacioni i vënë në dispozicion, rezulton se ka nivel të lartë debitorësh në vlerë si më poshtë:

Tabela nr. 4. Gjendja e debitorëve në datë 31.12.2024 në mijë lekë

| Nr | Emërtimi | Debia 2023 | Shtesat 2024 | Vlera e Kontabilizuar 2024 |
|---------------|------------------|----------------|----------------|----------------------------|
| 1 | Financa | | 27,219 | 27,219 |
| 2 | Biznesi | 251,879 | 81,064 | 332,943 |
| 3 | Tarifa Familjare | 50,947 | 342,139 | 393,085 |
| 4 | Urbanistika | | 44,380 | 44,380 |
| Totali | | 302,825 | 494,803 | 797,628 |

Burimi: Bashkia Vorë, përpunuar nga grupi i auditimit

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh për taksat dhe tarifave vendore, ku në fund të vitit 2023 vlera e debitorëve rezulton 302,825 mijë lekë, shtesat gjatë vitit 2024 janë në shumën 423,202 mijë lekë. Detyrimet progresive në fund të vitit 2024 janë në shumën 726,028 mijë lekë, e cila përbëhet nga:

- Detyrimet debitorë nga biznesi i madh dhe i vogël në shumën 332,943 mijë lekë;
- Detyrimet debitorë nga familjarët në shumën 393,085 mijë lekë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë nuk është në përputhje me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, me Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9632 datë 30.01.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe VKB nr. 16 datë 25.03.2024 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesa të paketës fiskale të vitit 2024.”

Konkluzion: Nga auditimi dhe referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga konstatohet se nga Drejtoria e Financës dhe ajo e Urbanistikës mbetet e paarkëtuar vlera prej 71,600 mijë lekë.

- **Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”**, në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në shumën 50,194 mijë lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2024, që trashëgohen në vitin 2025. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit:

Tabela nr. 5. Gjendja e llogarisë 4342 më 31.12.2024 në mijë lekë

| Emërtimi i llogarive | Vlera |
|---|---------------|
| Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” | 14,245 |
| Paga personeli llog.42 | 25,672 |
| Tatim mbi të ardhurat llog. 431 | 2,353 |
| Sigurime shoqërore llog.435 | 6,948 |
| Sigurime shëndetësore llog.436 | 967 |
| Sigurime suplementar llog.438 | 9 |
| Totali | 50,194 |

Burimi: Bashkia Vorë

Gjendja e llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” pasqyron detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërpasiv në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

-**Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, në aktivin e bilancit, në mbyllje të vitit 2024, paraqitet në shumën 168,208 mijë lekë. Kjo shumë përfaqëson detyrime të prapambetura të regjistruara për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të pafinancuara. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit:

Tabela nr. 6. Gjendja e llogarisë 486 më 31.12.2024 në mijë lekë

| Emërtimi i llogarisë | Vlera në lekë |
|--------------------------------------|----------------|
| Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” | 168,208 |
| Totali | 168,208 |

Burimi: Bashkia Vorë

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

- Auditimi i aktiveve afatgjata materiale.

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

-Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve afatgjata materiale, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata materiale në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata materiale;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

-Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për t'u siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivët Afatgjata**”, në aktiv të bilancit paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën neto 4,698,732 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,233,162 mijë lekë, ku diferenca përfaqëson shtesën e aseteve dhe vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,455,634 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 5,248,907 mijë lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale”

-Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 73,336 mijë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën 86,278 mijë lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”,

gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 114,200 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar gjendja e kësaj llogarie paraqitet në Aneksin 1/3 bashkëlidhur PRA.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2024.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale”, paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,262,806 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 3,694,324 mijë lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 5,134,707 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,341,435 mijëlekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”,** në mbyllje të vitit 2024 paraqitet me vlerë neto 29,533 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 29,520 mijë lekë. Edhe sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, paraqitet me këto vlera. Kjo llogari është shtuar nga viti i kaluar me vlerën 13 mijë lekë për objektin “Kolaudim sheshi Varrezave Sul Haxhi Palaq”. Kjo gjendje paraqitet e analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 7. Llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” më datë 31.12.2024 në mijë lekë

| Nr. | Përshkrimi | Vlera |
|---------------|--|---------------|
| 1 | Masterplani dhe Plani Rregullues i Bashkisë Vorë | 5,000 |
| 2 | Qendra Sportive Marikaj | 15,003 |
| 3 | Shesh Ambjente Sportive Shkolla Marqinet | 238 |
| 4 | Rrethimi i Ish Repartit Ushtarak Marqinet | 366 |
| 5 | Rrethim dhe Sist.i Fushës së Sportit Marqinet | 2,985 |
| 6 | Sistemim i Fushes Sportive Ahmetaq | 5,928 |
| 7 | Kolaudim Sheshi Varrezave Sul Haxhi Palaq | 13 |
| Totali | | 29,533 |

Burimi: *Bashkia Vorë*

- **Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”,** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerë neto 310,137 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 49,693 mijë lekë. Në të njëjtat vlera paraqitet dhe në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”. Rritja e kësaj llogarie në vlerën 260,444 mijë lekë vjen nga inventarizimi fizik i aktiveve që i përkasin kësaj llogarie dhe rakordimi i të dhënave ndërmjet Drejtorisë së Menxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit dhe ndërmjet Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës. Llogaria analitike paraqitet në Aneksin 1/4 bashkëlidhur PRA.

-**Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”,** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerë neto 556,884 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 225,752 mijë lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/a paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 639,882 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 279,441 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 janë pakësuar aktive për shkak të amortizimit në vlerën 29,310 mijë lekë dhe janë shtuar nga kapitalizimi aktive në vlerën 360,441 mijë lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet për vitin 2024, sipas inventarit në vlerë bruto paraqitet në Aneksin 1/5 bashkëlidhur PRA.

-**Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”,** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën neto 3,280,132 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,301,671 mijë lekë. Gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/a paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 3,961,652,392 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,802,157,483 lekë. Gjatë vitit 2024 janë bërë shtesat nga kapitalizimi në vlerën 159,495 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet për vitin 2024 paraqiten në Aneksin 1/6.

-Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerë neto 15,268 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 19,085 mijë lekë. Ndërsa gjendja sipas Formatit nr.7/a paraqitet në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 39,323 mijë lekë, ku është pakësuar gjatë vitit 2024 nga amortizimi vjetor. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 8. Llog 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” më datë 31.12.2024.

në mijë lekë

| Nr | Emërtimi | Vlera |
|---------------|---|---------------|
| 1 | Tabela Sinjalistike | 142 |
| 2 | Stabilizator | 300 |
| 3 | Turbina | 150 |
| 4 | Bazamente Kazanesh | 1,880 |
| 5 | Pemë Dekorative | 400 |
| 6 | Tabela Sinjalistike | 392 |
| 7 | Pemë Dekorative | 396 |
| 8 | Gjenerator | 1,878 |
| 9 | Vendosje Tabela Kufizuese Shpejtesie | 1,595 |
| 10 | Pajisje Banjo Për Bashkinë | 153 |
| 11 | Program Kompjuteri Financa 5 | 390 |
| 12 | Kazanë Mbeturinash | 6,001 |
| 13 | Blerje Kabulli Dhe Ndriçues Për Linjat E Ndriçimit Publik | 822 |
| 14 | Vendosja E Matësave Të Ujit Në Qytetin E Vorës | 447 |
| 15 | Blerje, Furnizim Dhe Vendosje Materiale Elektrike Për Linjat E Ndriçimit Publik | 2,4737 |
| 16 | Ndërtim Bazamenti Kazanash Për Koshat E Mbeturinave Në Njësitë Vorë, Prezë, Bërxull | 1,995 |
| 17 | Transferime Prezë e Bërxull | 19,909 |
| Totali | | 39,323 |

Burimi: *Bashkia Vorë*

- Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”, në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 28,241 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,362 mijë lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7 paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 51,395 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 39,222 mijë lekë, gjë që tregon se ka shtesa në vlerën 12,173 mijë lekë dhe pakësim amortizimi në vlerën 7,060 mijë lekë në vitin 2024. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2023 dhe 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 9. Llog. 215 "Mjete transporti" me datë 31.12.2024

në mijë lekë

| Nr | Emërtimi | Vlera |
|---------------|--|---------------|
| 1 | Autoveturë Fuoristradë për Titullarin e Bashkisë | 7,988 |
| 2 | Eskavatori | 9,055 |
| 3 | Automjet Zjarrfikës | 5,580 |
| 4 | Automjet Per Nevojat E Bashkise Vorë | 1,439 |
| 5 | Fuoristradë I X 35 | 3,180 |
| 6 | Automjet KAMA | 534 |
| 7 | Kamion Riportabel (Plerash) RENO | 1,880 |
| 8 | Bot Uji | 2,400 |
| 9 | Blerje Makine E Re Ngarkuse Me Goma (Fadrome Per Nevojat E Bashkise) | 2,486 |
| 10 | Minieskavator | 4,680 |
| 11 | Zjarrfikese Mzsh | 8,093 |
| 12 | Volksëagen Transport Ëyizzz7729x012669 | 2,040 |
| 13 | Citroen Jumber Vfzydbmob 11909049 | 2,040 |
| Totali | | 51,395 |

Burimi: *Bashkia Vorë*

- Gjendja e llogarisë 218, në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 34,636 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 45,474 mijë lekë. Sipas Formatit nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 102,785 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 102,079 mijë lekë. Shtesa në vlerën 1,079 mijë lekë për gjatë vitit 2024.

-Gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, në pasqyrat financiare të vitit 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie nuk është pasqyruar pjesëmarrja e Bashkisë Vorë si ortak i vetëm i K. F. V. SH.A. në vlerën 2,000 mijë lekë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, neni 31, pika a), në momentin fillestar të pjesëmarrjes me kapital, njësi të qeverisjes së përgjithshme duhet të kryejnë regjistrimin kontabël përkatës duke debituar llogarinë 26 “Pjesëmarrja me kapitalin e vet” dhe kredituar llogarinë 1011 “Shtesa të fondit bazë”.

Tabela nr. 10: Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2024 paraqiten në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

| N r. | Nr. Llog | Emërtimi | Fillim vit | Blerje e krijuar me pagese | Shtesa pa pagese brenda sistemit | Gjithsej | Nx.jasht përdo | Në mbyllje të ushtrimit |
|------|----------|---|------------------|----------------------------|----------------------------------|----------------|----------------|-------------------------|
| 1 | 20 | I. AAGJ/JO MATERIALE | 114,200 | - | - | - | - | 114,200 |
| 2 | 201 | Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave | - | | | - | | - |
| 3 | 202 | Studime dhe kerkime | 114,200 | | | - | | 114,200 |
| 4 | 203 | Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme | - | | | - | | - |
| 5 | 21-28 | II. AAGJ/ MATERIALE | 4,341,435 | 533,201 | 260,757 | 793,958 | 686 | 5,134,707 |
| 6 | 210 | Toka,troje, Terene | 29,520 | 13 | | 13 | | 29,533 |
| 7 | 211 | Pyje,Kullota Plantacione | 49,693 | | 260,444 | 260,444 | | 310,137 |
| 8 | 212 | Ndertime e Konstruksione | 279,441 | 360,441 | | 360,441 | | 639,882 |
| 9 | 213 | Rruge,rrjete,vepra ujore | 3,802,157 | 159,495 | | 159,495 | | 3,961,652 |
| 10 | 214 | Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune | 39,323 | | | - | | 39,323 |
| 11 | 215 | Mjete transporti | 39,222 | | | 12,173 | | 51,395 |
| 12 | 216 | Rezerva shtetërore | - | | | - | | - |
| 13 | 217 | Kafshe pune e prodhimi | - | | | - | | - |
| 14 | 218 | Inventar ekonomik | 102,079 | 1,079 | 313 | 1,392 | 686 | 102,785 |
| 15 | 24 | Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara | - | | | - | | - |
| 16 | 28 | Caktime | - | | | - | | - |
| 17 | | T O T A L I (I + II) | 4,455,634 | 533,201 | 260,757 | 793,958 | 686 | 5,248,907 |

Burimi: Bashkia Vorë

- **Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale,** paraqitet në bilanc në vlerën 237,904 mijë lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9. Llogaritja e Amortizimit për Aktivet është bërë në grup sipas natyrës së aktiveve dhe jo në mënyrë individuale për secilin aktiv duke e bërë të pamundur vlerësimin e vlerës neto të cdo aktivi në mënyrë individuale. Kjo mënyrë e përlllogaritjes nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme”, i cili përcakton se “amortizimi vjetor i aktiveve afatgjata duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur për kategoritë përkatëse të aktiveve”.

- **Gjendja e llogarisë 230,** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë pasi nuk ka Investime në Aktive të Patrupëzuara në Proces.

- **Gjendja e llogarisë 231,** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 362,590 mijë lekë.

Tabela nr. 11. Gjendja e llogarisë 231 më datë 31.12.2024 në mijë lekë

| Lëvizjet e llogarisë | Vlera |
|-------------------------------|----------------|
| Gjendja në 01.01.2024 | 363,290 |
| Shtesa gjatë vitit 2024 (D) | 431,057 |
| Pakësime gjatë vitit 2024 (K) | 431,757 |
| Gjendja në 31.12.2024 | 362,590 |

Burimi: Bashkia Vorë

Tabela nr. 12: Gjendja e Investimeve në Aktive Afatgjata Materiale në Proces në mijë lekë

| Nr | Emërtimi | Vlera |
|---------------|---|----------------|
| 1 | Rruga Pashtriku dhe ndertim I rrjetit KUZ rruga Liqenit NJA.Berxull | 20,000 |
| 2 | "Rindertimi I shkolles Isa Boletini Vorë" | 92,453 |
| 3 | Sistemim, Asfaltim i Rrugës Pashtriku dhe Ndërtim i Rrjetit KUZ; Rruga e Liqenit; Njësia Administrative Bërçull; Domje; Bashkia Vorë | 9,538 |
| 4 | Sistemim, Asfaltim i Rrugës Pashtriku dhe Ndërtim i Rrjetit KUZ; Rruga e Liqenit; Njësia Administrative Bërçull; Domje; Bashkia Vorë | 10,462 |
| 5 | Sistemim asfaltim I rrugëve Kodra e Miut, dhe rindertimi I fshatit Marqinet, Investime të Reja) | 15,211 |
| 6 | Sistemim - Asfaltim i Rrugëve Domje, Rruga Ramadin Zazckocki + Rruga Kodra e Totëve, Rruga Ismail Qemali, Rruga Naim Frasherit, Njësia Administrative Bërçull, Bashkia Vorë | 19,510 |
| 7 | Sistemim - Asfaltim i Rrugëve Domje, Rruga Ramadin Zazckocki + Rruga Kodra e Totëve, Rruga Ismail Qemali, Rruga Naim Frasherit, Njësia Administrative Bërçull, Bashkia Vorë | 20,435 |
| 8 | Sistemim, Rrugeve Kodra e Miut dhe Rindertimi Fshatit Marqinet 2 | 49,114 |
| 9 | Sistemim i Fushes Sportive Ahmetaq 2023 | 5,928 |
| 10 | Përforcimi i Skarpatës Se Rruges "Gjokaj" Me Mur B/A | 5,406 |
| 11 | Rindertimi i Shkolles 9 - Vjecare Picar | 45,613 |
| 12 | Sistemim, Asfaltim Rrugeve Hashnjët, Takeve Dhe Tafëve, Njesia Administrative Berxulle, Bashkia Vore | 68,920 |
| Totali | | 362,590 |

Burimi: Bashkia Vorë

Inventarizimi, vlerësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2024 për Bashkinë Vorë dhe njësitë administrative në varësi të saj.

Për realizimin e këtij procesi, është nxjerrë urdhri i titullarit nr. 190 prot., datë 07.11.2024, “Për ngritjen e Komisionit të Inventarizimit fizik të aktiveve në Bashkinë Vorë për vitin 2024”, në bazë të të cilit është përcaktuar përbërja e komisionit përgjegjës.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për këtë qëllim, rezultoi se komisionet e ngritura kanë hartuar fletët e inventarit me pasqyrimin e gjendjes fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, si dhe gjendjen kontabël sipas llogarive përkatëse. Këto fletë janë konfirmuar nga komisionet dhe nga përgjegjësit materialë brenda muajit dhjetor 2024 dhe rezultojnë pa diferenca ndërmjet gjendjes fizike dhe asaj kontabël. Është hartuar gjithashtu një relacion përmbledhës mbi inventarizimin, ku përshkruhen mënyra e ruajtjes së aktiveve dhe konfirmimi i përputhshmërisë së inventarit.

Gjithashtu, me urdhrin nr. 202, datë 27.12.2024, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të aktiveve të Bashkisë Vorë, ku janë përcaktuar detyrat përkatëse. Në zbatim të këtij urdhri, është hartuar procesverbali i vlerësimit të aktiveve me nr. 6831/1, datë 27.12.2024.

Po ashtu, me urdhrin nr. 203, datë 30.12.2024, është ngritur Komisioni i Nxjerrjes Jashtë Përdorimit dhe Asgjësimit të aktiveve të Bashkisë Vorë. Në zbatim të këtij urdhri është përgatitur relacioni përkatës nr. 6841/1, datë 30.12.2024, mbi asgjësimin e aktiveve, sipas të cilit janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive që i përkasin:

- Llogarisë 218, në vlerën 686 mijë lekë;
- Llogarisë 327, në vlerën 1,281 mijë lekë.

Ky proces është realizuar në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

PASIVET (DETYRIMET)

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Vorë më datë 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2024, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e

kontratave, kreditorë të ndryshëm etj. Tabela analitike e llogarive të pasivit paraqitet në Aneksin 1/7 bashkëkidhur PRA.

Pasivet afatshkurtra

Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **1,075,315 mijë** lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

-Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikuiduara. Gjendja e kësaj llogarie në pasiv të bilancit në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 14,245 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 14,450 mijë lekë, vlerë e cila ka ndryshuar me faturat e muajit dhjetor.

Tabela nr. 13: Përbërja e llog. 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në mijë lekë

| Nr. | Përshkrimi | Vlera |
|---------------|--|---------------|
| 1 | PAK Janar 2025 | 10,510 |
| 2 | Ndihmë ekonomike Dhjetor 2024 | 601 |
| 3 | Invaliditeti Dhjetor 2024 | 13 |
| 4 | Energji elektrike Dhjetor 2024 | 816 |
| 5 | Ujë dhjetor 2024 | 790 |
| 6 | Honorare këshilltare, objekte me qera Dhjetor 2024 | 919 |
| 7 | Objekte me qera Bashkia | 595 |
| Totali | | 14,245 |

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 25,672 mijë lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2024, për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2025.

- Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën kontabël 2,353 mijë lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2024 për detyrimet tatimit mbi pagën në shumën 1,680 mijë lekë që do të paguhen në janar të vitit 2025 dhe tatim i mbajtur në burim në vlerën 673 mijë lekë.

- Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 6,948 mijë lekë, të llogaritura për t’u paguar në muajin pasardhës.

- Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën kontabël 967 mijë lekë.

- Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 59,286 mijë lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Tiranë. Gjatë vitit 2024 shuma e likuiduar është 28,442 mijë lekë.

-Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 168,208 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 363,290 mijë lekë me një diferencë në ulje prej 195,083 mijë lekë. Ulja e kësaj vlerë tregon dhe uljen e kreditorëve të ndryshëm pas likuidimit të tyre. Në gjendjen e kësaj llogarie janë shtuar vlera të mbartura duke filluar nga viti 2006 në llogarinë 401-408 “Furnitorë të ndryshëm” të cilat i përkasin furnizimeve të vjetra apo diferencave në faturim. Një pjesë e tyre janë të papagueshme. Këto detyrime duhen analizuar për të evidentuar nëse janë të pagueshme apo jo dhe duhet rivlerësuar pozicioni i tyre në pasqyrat financiare. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 14. Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”. në mijë lekë

| Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm" | |
|--|----------------|
| Çelje e vitit 2024 | 363,290 |
| Shtesa | 14,450 |
| Pakësime | 209,533 |
| Gjendja në 31.12.2024 | 168,208 |

Burimi: Bashkia Vorë, përpunuar nga grupi i KLSH-së

Shtesat gjatë vitit 2024 i përkasin kalimit të tepricës së mbartur të llogarisë 401-408 “Furnitorë të ndryshëm” në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH.

Pakësimi në vlerën 209,533 mijë lekë ka të bëjë me likuidimin e kreditorëve gjatë vitit 2024. Parqitja analitike e furnitorëve paraqitet në aneksin 1/8.

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

Të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Vorë më datë 31.12.2024 janë të kuadruar me Degën e Thesarit Tiranë, konkretisht:

Tabela nr. 15. Rakordimi të ardhurave në mijë lekë

| Emërtimi | Vlera sipas Pasqyrës së Performancës | Dokumentimi | Vlera | Diferenca |
|-------------------------------------|--------------------------------------|--|------------------|-----------|
| -Të ardhurat e krijuara gjatë vitit | 523,148 | Akt rakordimin me Degën e Thesarit | 523,148 | - |
| -Granti nga buxheti | 526,753 | Sipas çeljes së buxhetit nga MFE | 526,753 | - |
| -Financim i pritshëm nga buxheti | - | Sipas llogarisë 7206 | - | - |
| -Fonde buxhetore të trashëguara | 193,336 | Akt rakordim Degën e Thesarit | 193,336 | - |
| -Të ardhura të trashëguara (rez) | 89,604 | Nga rezultati i vitit të mëparshëm llog.85 | 89,604 | - |
| -Llog 73 Ndryshim i gjendjes me(+) | 7,147 | Sipas llog 63 me (+) | 7,147 | - |
| Totali të ardhura | 1,339,989 | Totali të ardhura | 1,339,989 | |

Burimi: Bashkia Vorë, përpunuar nga grupi i auditimit të Klsh-së

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas rakordimit me Degën e Thesarit paraqiten në Aneksin 1/9 bashkëlidhur PRA.

-Të ardhurat nga taksat dhe tarifet janë realizuar në vlerën 674,287 mijë lekë nga 523,148 mijë lekë të parashikuara, ose në masën 78% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 151,139 mijë lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se:

-Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta si:

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pasurisë të paluajtshme në masën 44%, Taksa e Tabeles në masën 55%, Tarifa Administrative në masën 67%, Tarifë për leje transporti në masën 50%, MNZ në masën 34%, Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin në masën 34%.

-Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin në masa të konsiderueshme si:

Taksa e tokës bujqësore në masën 152%, Taksa e truallit në masën 111%, Taksa e fjetjes në hotel në masën 508%, Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në masën 128%, Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve në masën 167%, Tarifë për shërbime publike (Pastrimi+ Ndotje ambjenti) në masën 180%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifet vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë jo në përputhje me Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9632 datë 30.01.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, kreu VII dhe Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu III.

Analizë: Formati nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”, paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 363,309 mijë lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Vorë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”**, paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 312,342 mijë lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi biznesin e vogël”**, pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 650 mijë lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

-Gjendja e llogarisë analitike **7010 “Tarifë Bankare për Shërbime ZVRPP”**, pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 91 mijë lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”**, pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 176,939 mijë lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **7021 “Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme”**, pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 4,317 mijë lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **7029 “Të tjera tatime mbi pasurinë”**, pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 2,216 mijë lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”**, pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 128,129 mijë lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”**, paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 179,060 mijë lekë, i cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”**, paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 1,657 mijë lekë, e cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë **7110 “Tarifë administrative dhe rregullatore”**, paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 121,362 mijë lekë, e cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë **7113 “Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve”**, paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 727 mijë lekë, e cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë **7115 “Gjoha, Kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime”**, paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 48,394 mijë lekë, e cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **72 “Grante Korente”**, është në vlerën prej 558,499 mijë lekë, vlerë e cila përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë **7200 “Nga buxheti për NJQP (Qendrore)”**, paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 526,753 mijë lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë **7201 “Nga buxheti për NJQP (Vendore)”**, paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 20,146 mijë lekë, e cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë **7204 “Pjesëmarrja e institucioneve në tatime nacionale”**, paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 11,599 mijë lekë, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

▪ Të ardhurat të hyra në llogarinë e Bashkisë sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 16. Burimet e financimit të buxhetit vjetor

në mijë lekë

| Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024 | | | |
|--|---|---|--|
| Burimi i të ardhurave | Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 69 datë 22.12.2023 | Buxheti shtesë VKB nr.17 date25.03.2024 | Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë) |
| Të ardhura të planifikuara për vitin 2024 | 662,287 | 6,000 | 668,287 |
| Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2024 | - | 78,604 | 78,604 |
| Total të ardhurat e veta | 662,287 | 84,604 | 746,891 |
| Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar | - | 33,207 | 33,207 |
| Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike | - | 142,996 | 142,996 |
| Transfertat e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2024 | 264,006 | 40,784 | 304,790 |
| Transfertat specifike e çelur për llogari të vitit 2024 | 111,121 | 30,658 | 141,779 |
| Transfertat e pakushtëzuar specifike | - | - | - |
| Fonde të Deleguara | 4,920 | 399,213 | 404,133 |
| Fonde (Të trashëguara për rindërtimin) | - | 28,474 | 28,474 |
| Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit | 380,047 | 675,332 | 1,055,379 |
| Totali i të ardhurave | 1,042,334 | 791,829 | 1,838,162 |

Burimi: *Bashkia Vorë*

2.2 Shpenzimet

Shpenzimet përfaqësojnë pakësim të përfitimeve ekonomike gjatë ushtrimit kontabël, në formën e daljes apo të pakësimit të vlerave të aktiveve apo rritjen e detyrimeve. Shpenzimet janë flukse dalëse gjatë periudhës raportuese, që kanë për rezultat zvogëlimin e kapitaleve të veta (fondeve), përfaqësojnë investimin që kryen njësia e qeverisjes së përgjithshme për realizimin e synimeve të tij të funksionimit gjatë një viti ushtrimor.

Buxheti vjetor i vitit 2024 është miratuar me VKB nr. 69 datë 22.12.2023, konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Tiranë me shkresën nr. 1690/1, datë 04.01.2024, i ndryshuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2024 sipas akordimit të burimeve të financimit dhe llogarive ekonomike të shpenzimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 17. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2024

në mijë lekë

| Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Vorë, për vitin 2024 | | | | | | | | | | | |
|---|-------------------------|---------|---------|-------------|------------------------|-------------------------------------|--------------------------------|--|---|---|--------------------------|
| Burimi i financimit të shpenzimit | | | | | | | | | | | |
| N r. | Përshkrim i Shpenzimeve | Plani | Fakti | Realizimi % | Nga të ardhurat e veta | % e mbulimit nga të ardhurat e veta | Nga Granti Qeveritar (FAKTI) | | | | % e mbulimit nga grantet |
| | | | | | | | Nga transfertat e pakushtëzuar | Nga transfertat e kushtëzuar specifike | Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara | Nga transfertat e kushtëzuar për investimet | |
| 1 | Paga 600 | 328,782 | 295,714 | 90% | 124,453 | 84% | 107,121 | 59,480 | 4,660 | - | 52% |
| 2 | Sigurime shoqërore 601 | 56,204 | 47,147 | 84% | 17,047 | 70% | 19,617 | 9,770 | 711 | - | 54% |
| 3 | ShP. Operat | 384,010 | 329,709 | 84% | 257,213 | 84% | 46,827 | 9,085 | 16,585 | - | 19% |

| | | | | | | | | | | | |
|---|-----------------------|------------------|------------------|------------|----------------|------------|----------------|----------------|----------------|----------|------------|
| | 602+ F. Rezervë | | | | | | | | | | |
| 4 | Nd/Ekonom invalid 606 | 427,696 | 295,088 | 69% | 10,193 | 39% | 11,696 | - | 273,199 | - | 67% |
| 5 | Investime 230-231 | 641,471 | 431,057 | 67% | 177,557 | 63% | 61,483 | 172,507 | 19,509 | - | 13% |
| | Totali | 1,838,163 | 1,398,715 | 76% | 586,463 | 75% | 246,744 | 250,842 | 314,664 | - | 35% |

Burimi: Drejtoria e Financës i përpunuar nga grupi i auditimit

Gjithashtu niveli i realizimit të buxhetit vjetor 2024 referuar akt-rakordimit me thesarin sipas llogarive ekonomike të shpenzimeve paraqitet në tabelën e mësipërme. Referuar këtyre të dhënave rezulton se fondet buxhetore janë realizuar në vlerën 1,398,715 mijë lekë nga 1,838,162 mijë lekë të planifikuara ose në masën 76%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar:

-Realizimi i ulët i shpenzimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore llog.601 në masën 84%, si rezultat i vakancave në strukturë;

-Realizimi i ulët i shpenzimeve operative, llog. 602 “Shpenzime për mallra dhe shërbime” në masën 84%;

-Llog. 606 “Ndihmë ekonomike invalid” në masën 69%;

-Llog. 231 “Shpenzimet për investime” me financim nga buxheti i bashkisë dhe transferta e kushtëzuar janë realizuar në masën 67%, si rezultat i moskryerjes së të gjitha investimeve të planifikuara për shkak të periudhës zgjedhore.

Tabela nr. 18. Mbi të ardhurat e trashëguara në mijë lekë

| Nr. | Përshkrimi | Vlera |
|-----|--|----------------|
| 1 | Bashkia Vorë (Të Ardhurat, Sektori i Shpenzimeve) | 19,717 |
| 2 | Bashkia Vorë (Të Ardhurat, Sektori i Të ardhurave) | 3,054 |
| 3 | Bashkia Vorë (Trasferta) + (Grantet e Rindërtimit) | 242,135 |
| 4 | Bashkia Vorë | 50 |
| | Totali | 264,955 |

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të të ardhurave të trashëguara mbështet edhe një herë faktin se Bashkia Vorë ka patur fonde në dispozicion për rritjen e performancës së realizimit të investimeve dhe nuk ka argument justifikues për realizimin në nivele aq të ulët të fondeve për investime, përveç mungesës së kapaciteteve dhe punës së pa mjaftueshme për vënien në efikasitet të fondeve brenda vitit ushtrimor dhe rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit në mënyrë që buxheti të jetë koherent me periudhën që financon. Buxheti i detajuar sipas burimeve të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 19. Buxheti sipas burimeve të financimit në mijë lekë

| Nr. | Transferta | Fakt 2024 | Pesha Specifike |
|-----|--|----------------------|-----------------|
| 1 | Nga të ardhurat e veta | 586,464,331 | 42% |
| 2 | Nga transferta e pakushtëzuar | 246,743,854 | 18% |
| 3 | Nga transferta e kushtëzuar specifike | 250,842,430 | 18% |
| 4 | Nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara | 314,664,582 | 22% |
| | Totali | 1,398,715,197 | 100% |

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave për vitin 2024 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 586,464 mijë lekë ose në masën 42 %, nga transferta e pakushtëzuar në shumën 246,744 mijë lekë ose në masën 18%; Nga transferta e kushtëzuar specifike në shumën 250,842 mijë lekë ose në masën 18 %, transferta e kushtëzuar në shumën 314,665 mijë lekë ose në masën 22 %.

Detyrimet e prapambetura

Situata e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2024 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 20. Situata e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2024 në mijë lekë

| Kodi i DP | Emërtimi | DP progresiv deri në dt. 31.12.2023 | Shtesa DP gjatë vitit 2024 | Pagesa gjatë vitit 2024 | DP datë 31.12.2024 |
|-----------|---|-------------------------------------|----------------------------|-------------------------|--------------------|
| 4864100 | Detyrime për vend. gjyqësore | 2,309 | - | 421 | 1,888 |
| 4864200 | D.P.për shërbime | 81,887 | - | 9,682 | 72,205 |
| 4864300 | D.P.për mirëmbajtje | | - | - | |
| 4864400 | D.P.për investime | 279,094 | - | 199,430 | 79,664 |
| 4864400 | D.P.për investime nga Ministrinë e Linjës (specifiko FZHR etj...) | | | | |
| 4865600 | D.P për mallra | | | | |
| 4864900 | D.P.të tjera | | | | |
| | Totali | 363,290 | - | 209,533 | 153,758 |

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi konstatohet se, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2023 kanë qenë në vlerën totale prej 363,290 mijë lekë, gjatë vitit 2024 nuk janë krijuar detyrime të reja dhe ka pasur shlyerje në vlerën 209,533 mijë lekë, duke rezultuar në fund të vitit 2024 një vlerë e detyrimeve të prapambetura prej 153,758 mijë lekë. Kjo vlerë përbëhet nga detyrime për investime në vlerën 79,664 mijë lekë, detyrime për shërbime në vlerën 72,205 mijë lekë dhe për vendime gjyqësore në vlerë 1,888 mijë lekë.

-Raportet e monitorimit.

Për vitin 2024 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit. Për vitin 2024 janë dërguar në MF raportet e detajuara si më poshtë:

“Raport monitorimi janar-prill 2024” me shkresën nr. 1934 prot., datë 16.05.2024.

“Raport monitorimi janar-gusht 2024” me shkresën nr. 1934 prot., datë 16.09.2024

“Raport monitorimi janar-dhjetor 2024” me shkresën nr. 866 prot., datë 17.02.2025.

Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se në to janë pasqyruar saktë treguesit e realizimit të buxhetit referuar dhe akt akordimit me Degën e Thesarit. Po kështu këto të dhëna janë pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë.

-Rakordimi i Shpenzimeve

Analiza e shpenzimeve të vitit 2024, të cilat në total janë në vlerën **304,202 mijë lekë** paraqitet më poshtë:

-Gjendja e llogarisë 600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli” për vitin 2024, paraqitet në pasqyrën e performancës në vlerën 135,217 mijë lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin.

-Gjendja e llogarisë 601 “Kontribute për sigurime”, paraqitet në pasqyrën e performancës në vlerën 22,347 mijë lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin.

-Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” paraqitet në pasqyrën e performancës në vlerën 62,695 mijë lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin.

-Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korrente të brendshme” paraqitet në pasqyrën e performancës në vlerën 2,463 mijë lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin.

-Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime për buxhetet familjare e Individë” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 77,236,290 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

-Gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është e barabartë me ndryshimin e gjendjes të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2024 është në vlerën (3,219) mijë lekë.

-Gjendja e shpenzimeve të tjera “Operacione të korrigjimit të rezultatit” për vitin 2024 paraqitet në bilanc në vlerën 7,462 mijë lekë.

Për vitin 2024 totali i të ardhurave rezulton në vlerën 363,309 mijë lekë dhe totali i shpenzimeve në vlerën 304,202 mijë lekë. Diferenca e tyre në vlerën 59,107 mijë lekë rakordon me gjendjen e llog. 85 “Rezultati i ushtrimit”.

Formati nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit”.

-Zëri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 362,590 mijë lekë në analizë tregon burimet e investimit nga buxheti i shtetit në vlerën 362,590 mijë lekë.

Nga testi i kontrollit për vitet 2023 dhe 2024 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 gërmat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të vendimit nr. 290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkuara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listëpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, nuk janë paraqitur pretendime/observacione nga subjekti i audituar Bashkia Vorë, për Projektraportin e auditimit të dërguar me shkresën nr. 736/2 prot., datë 11.09.2025.

2.3.Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Në zbatim të programit të auditimit, pika 3, u auditua zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm në Bashkinë Vorë. Për auditimin e kësaj pike u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, si më poshtë vijon:

1. *Shkresa përcjellëse nr. 1089/10 Prot., datë 06.03.2025 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.*
2. *Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit.*
3. *Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 6-muajsh) së bashku me raportin për zbatimin e rekomandimeve të lëna.*
4. *Dokumentacion tjetër i paraqitur lidhur me vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve.*

Nga auditimi u konstatua se:

1. Me shkresën nr. 1289/1 prot., datë 27.03.2025 “Kthim përgjigje për raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet e lëna”, Bashkia Vorë ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit nr. 1289/2 prot., datë 27.03.2025, për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

2. Bashkia Vorë nuk ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Lidhur me këtë detyrim ligjor, referuar shkresës përcjellëse me nr. 1089/10 prot., datë 06.03.2025 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës, nuk mund të shprehemi pasi është brenda afatit 6 - mujor.

Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Vorë:

Nga KLSH janë lënë gjithsej **54** rekomandime, të grupuara në:

-29 masa organizative;

-8 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në të ardhurat e munguara nga taksat dhe tarifatat vendore, dhe në menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre;

-5 masa për uljen e detyrimeve të papaguara tatimore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara);

-12 masa disiplinore.

-Për zbatimin e rekomandimeve të lëna, nga Kryetari i Bashkisë Vorë është nxjerrë urdhri me nr. 39, nr. 1481 prot., datë 20.03.2025 për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH.

Me urdhrin e brendshëm nr. 1482 prot., datë 20.03.2025 është ngritur komisioni i disiplinës për vlerësimin e përgjegjësisë dhe marrjen e masës disiplinore ndaj punonjësve të përmendur në raportin përfundimtar të auditimit;

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 29 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 21 janë zbatuar, 7 janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.

Pra janë zbatuar 72% e masave organizative dhe 3 % nuk janë zbatuar.

- Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në të ardhurat e munguara nga taksat dhe tarifat vendore dhe në menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre, janë lënë 8 rekomandime në vlerën 43,896 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat nuk janë zbatuar 3 rekomandime, 4 rekomandime janë në proces dhe 1 rekomandim është i pazbatuar.

- Masa për uljen e detyrimeve të papaguara tatimore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia janë lënë 5 rekomandime në vlerën 457,674 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht. Nga rekomandimet e lëna rezulton se është në proces zbatimi 1 rekomandim për vlerën 73,463 mijë lekë dhe 4 rekomandime të zbatuara.

- Janë dhënë 12 masa disiplinore dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të theksuara midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për saktësimin e hartimit të tij, mbështetur në realizimet e mëparshme dhe mundësitë objektive të të ardhurave dhe shpenzimeve, për të vijuar me analiza periodike të veprimtarisë për realizimin e buxheteve, për të siguruar buxhete reale në shërbim të qytetarëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se në lidhje me rekomandimin e mësipërm për mos krijimin e diferencave në parashikimin dhe realizimin e buxhetit dhe saktësimin në hartimin e tij, është bërë një reflektim që buxhetet shtesë mos të mbeten pa u shpenzuar, si dhe procedurat e prokurimit të mbyllen brenda afateve për mos të krijuar diferenca të pa paguara.

Në lidhje me diferencat e të ardhurave është bërë e mundur saktësimi i të ardhurave dhe mbledhja e të ardhurave në % më të lartë për vitin 2024, që dhe realizimi i shpenzimeve të jetë në nivelin e parashikuar. Për sa i përket fondeve të rindërtimit aty ku është dhe diferenca më e mëdha e fondeve gjendje dhe e pa përdorur një pjesë e konsiderueshme e këtyre fondeve vjen nga burime specifike dhe të dedikuara, përdorimi i tyre është i orientuar drejt projekteve të planifikuara, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e financave publike. Shpërndarja është bërë në mënyrë që të adresohet si nevojë për përfundimin e investimeve ekzistuese, ashtu edhe nisjen e projekteve të reja që përmirësojnë cilësinë e jetës së banorëve.

Është bërë dhe planifikimi i shpërndarjes së fondeve sipas artikujve dhe llogarive përkatëse, në përputhje me natyrën e tyre dhe objektivat strategjike të bashkisë.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 **rezulton i zbatuar**

2.1. Rekomandimi: Këshilli i Bashkisë Vorë, të marrë në analizë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar në vështirësitë e gjendjes financiare.

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit, të marrin masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë stokun e detyrimeve të papaguara gjatë viteve paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e njësisë vendore gjatë viteve në vazhdim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se, Kryetari i Bashkisë Vorë ka analizuar dhe ka nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar në vështirësitë e gjendjes financiare dhe ka dërguar një plan shlyerje për detyrimet në Këshillin Bashkiak, miratuar me vendimin nr. 50, datë 26.07.2023, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe të financojë projektet e nisura por të papërfunduara si dhe të sigurojë stabilitetin financiar të Bashkisë Vorë në përmbushjen e detyrimeve të saj institucionale dhe zhvëllimore.

Në lidhje me rekomandimin 2.2, Kryetari i Bashkisë Vorë dhe drejtoritë përkatëse janë angazhuar maksimalisht për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Gjatë vitit 2024, janë likuiduar të gjitha detyrimet e mbetura për vitin 2023 në vlerën 209,532,527 lekë. Stoku i detyrimeve të prapambetura deri me 31.12.2024 është në vlerën 153,757,844 lekë të cilat janë planifikuar për t'u shlyer gjatë vitit 2025. Bashkia Vorë aktualisht nuk është në vështirësi financiare.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 **rezulton i zbatuar**

Zbatimi: Rekomandimi 2.2 **rezulton në proces zbatimi**

3.1.Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik, të marrë masa për hartimin e metodologjisë për parashikimin e të ardhurave vendore bazuar në faktorët përkatës, duke identifikuar dhe vlerësuar kontrollin e risqeve që çenojnë arritjen e objektivave për realizimin e të ardhurave të planifikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me rekomandimin 3.1, rezulton se nga Bashkia Vorë janë marrë masat dhe është hartuar regjistri i riskut, ku janë përcaktuar objektivat lidhur me të ardhurat vendore dhe janë identifikuar risqet që mund të ndikojnë në realizimin e tyre. Në vijim të këtij procesi, është bërë parashikimi i të ardhurave, duke marrë parasysh këto objektiva dhe vlerësimin e risqeve.

Parashikimi është kryer në përputhje me nenin 14 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 2, datë 06.2.2019, të cilët kërkojnë planifikim të bazuar në objektiva të qarta dhe analizë të risqeve që ndikojnë në buxhet.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 **rezulton i zbatuar**

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të vlerësojnë, analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për taksën mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, për mos përditësimin e të dhënave të regjistrimit të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme me të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë (Kadastra Fiskale) për të definuar individët, personat fizikë ose juridikë që i nënshtrohen taksimit/përrjashtimit për këtë kategori taksapaguesish.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se bazuar në urdhërat nr. 98, datë 08.09.2024 dhe nr. 111, datë 05.03.2025 të Kryetarit të Bashkisë Vorë për “Ngritjen e grupit të punës për mbledhjen e bazës së të dhënave dhe verifikimin në terren të objekteve për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurive të paluajtshme”, janë ngritur grupe pune për mbledhjen e bazës së të dhënave sipas verifikimit dhe matjeve në terren për objektet që përdoren për veprimtari tregtare dhe për objektet për qëllime banimi. Regjistri i bazës së të dhënave përditësohet ndërmjet konstatimeve nga ana e specialistëve të terrenit të dokumentuara në procesverbalet e konstatimit.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 **rezulton i zbatuar**

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vorë, të marrë masa për klasifikimin e saktë të aktiveve, sistemimin e vlerave me kosto historike së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogaritur, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vorë ka bërë klasifikimin e saktë të aktiveve, në përputhje me natyrën dhe funksionin e tyre ekonomik si dhe sistemimin e vlerave me kosto historike të aktiveve bashkë me pasqyrimin e vlerës së amortizimit të përlllogaritur. Këto veprime janë bërë për garantimin e saktësisë dhe transparencës në administrimin financiar dhe kontabël të pasurive të Bashkisë. Është realizuar përditësimi i regjistrit të aktiveve me të gjitha pasuritë, i cili përfshin: përshkrimin e pasurisë, kategorinë sipas klasifikimit kontabël (materiale, jomateriale, etj.) koston historike, vlerën e amortizuar deri më 31.12.2024.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 **rezulton i zbatuar**

6.1. Rekomandimi: Këshilli Bashkiak Vorë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për shërbimet kontraktore ndërmjet institucionit dhe furnitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë të marrë masa që për çdo shërbim kontraktual i cili kryhet për nevoja të institucionit, personat përgjegjës të ndjekin të gjithë procedurat ligjore të marrjes në dorëzim të mallit me lënien e gjurmës së auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.3. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar të kryejë sistemimin e Llogarisë nr. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, për vlerën 11,506,064 lekë duke i kontabilizuar në Llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, si detyrime të prapambetura.

Brenda vitit 2025

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me rekomandimin 6.1, rezulton se në muajin maj 2025, është mbledhur Këshilli Bashkiak dhe me vendim nr. 1898, datë 12.05.2025, ka miratuar Raportin e Monitorimit për vitin 2024.

Në këtë vendim janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të detajuar të gjitha përgjegjësitë institucionale, duke identifikuar se cilës drejtori i takon ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura ndërmjet kontraktorëve dhe institucionit, dhe është vendosur që:

-Çdo drejtori funksionale të mbajë përgjegjësi për kontratat që lidhen me fushën e saj të veprimtarisë;

- Të sigurohet monitorimi i rregullt teknik dhe financiar i shërbimeve të kontraktuara;
- Të ketë raportim periodik mbi ecurinë e zbatimit të kontratave dhe zgjidhjen e çdo problematike të evidentuar.

Në lidhje me rekomandimin 6.2, Bashkia Vorë ka marrë masat përkatëse për zbatimin e këtij rekomandimi. Për të gjitha kontratat e shërbimeve dhe furnizimeve të realizuara, në momentin e marrjes së shërbimit/mallit, hartohet procesverbal pranimi, ku specifikohet numri dhe data e procesverbalit, përshkrimi i shërbimit ose mallrave të dorëzuara, sasia, cilësia dhe përputhshmëria me kontratën. Pranimi kryhet nga një komision me 3 anëtarë, i ngritur me urdhër të brendshëm të nxjerrë nga titullari i institucionit, në përputhje me udhëzimin nr. 30, datë 16.12.2011 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në lidhje me rekomandimin 6.3 rezulton se, llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 25,751,319 lekë, e cila pasqyrohet në mënyrë analitike në regjistrat kontabël. Gjatë verifikimeve u konstatua se vlera prej 11,506,064 lekë, që i përkiste detyrimeve të prapambetura ndaj furnitorëve, është transferuar dhe kontabilizuar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” sipas kërkesës së rekomandimit. Si rrjedhim, llogaria 401-408 përfshin vetëm detyrimet aktuale ndaj furnitorëve, ndërsa detyrimet e prapambetura reflektohen siç duhet në llogarinë 467.

Zbatimi: Rekomandimi 6.1 **rezulton i zbatuar**

Zbatimi: Rekomandimi 6.2 **rezulton i zbatuar**

Zbatimi: Rekomandimi 6.3 **rezulton i zbatuar**

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse mbi menaxhimin e debitorëve të bashkisë.

Menjëherë

7.2. Rekomandimi: Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vorë, të evidentojë listat emërore të debitorëve kategoria familjare në mënyrë elektronike, si dhe në zbatim të kuadrit ligjor, të përcjellë dokumentacionin e nevojshëm në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, për kontabilizimin e detyrimeve në pasqyrat financiare.

Menjëherë

7.3. Rekomandimi: Drejtorja e Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme në sistemin e Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke kontabilizuar të gjithë vlerat debitorë të trashëguara në vite.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me rekomandimin 7.1 rezulton se, Kryetari i Bashkisë ka zhvilluar një analizë të detajuar mbi situatën e debitorëve, duke u bazuar në të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave dhe informacionin nga sektorët përkatës financiarë. Janë marrë këto masa konkrete: Është hartuar dhe miratuar një raport analitik për gjendjen e debitorëve sipas kategorive të të ardhurave dhe periudhave kohore. Janë identifikuar strukturat përgjegjëse që nuk kanë ndjekur në mënyrë të rregullt procesin e evidentimit, ndjekjes dhe arkëtimit të detyrimeve. Është lëshuar një urdhër i brendshëm për riorganizimin e punës dhe për ndarjen e përgjegjësisë të qarta administrative për ndjekjen e debitorëve. Është ngritur një grup pune për të mbikëqyrur dhe përshpejtuar procesin e arkëtimit të detyrimeve të prapambetura. Janë përgatitur njoftime zyrtare dhe paralajmërime ligjore për debitorët kryesorë në bashkëpunim me strukturat ligjore të bashkisë.

-Në lidhje me rekomandimin 7.2 rezulton se Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vorë, bazuar në urdhrin nr. 30 datë, 24.02.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vorë "Për

regjistrimin në kontabilitet të listës së debitorëve për taksat dhe tarifave vendore", janë dërguar për kontabilizim pranë Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Programeve të strehimit, listat emërore të debitorëve të subjekteve të Biznesit të Madh, Biznesit të Vogël dhe Kategorisë Familjare, në mënyrë shkresore dhe elektronike me shkresat nr. 179 prot., datë 17.03.2025 dhe nr. 147 prot., datë 27.03.2025.

-Në lidhje me rekomandimin 7.3 rezulton se Drejtoria e Menaxhimit Financiar, pasi i është përcjellë shkresa përkatëse bashkëngjitur me relacionin shpjegues dhe listat e evidentuara për të gjitha kategoritë e debitorëve, ka kryer veprimet e mëposhtme:

-Ka regjistruar dhe evidentuar detyrimet e debitorëve sipas kategorive përkatëse në sistemin financiar të njësisë;

-Është bërë klasifikimi kontabël i detyrimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave;

-Të dhënat janë pasqyruar në regjistrat zyrtarë financiarë sipas standardeve të kontabilitetit për sektorin publik;

-Për çdo kategori është përgatitur dokumentacioni mbështetës për efekt auditimi dhe raportimi financiar;

-Është siguruar gjurmueshmëri dhe transparencë për çdo veprim financiar të kryer, bashkëngjitur tabela e mëposhtme, të pasqyruar në pasqyrat financiare 2024.

| Nr. | Emërtimi | Debia 2023 | Shtesat 2024 | Vlera e kontabilizuar 31.12.2024 |
|---------------|------------------|-------------|--------------|----------------------------------|
| 1 | Financa | | 27,219,428 | 27,219,428 |
| 2 | Biznesi | 251,878,895 | 81,063,987 | 332,942,882 |
| 3 | Tarifa Familjare | 50,946,561 | 342,138,516 | 393,085,077 |
| 4 | Urbanistika | | 44,380,297 | 44,380,297 |
| Totali | | 302,825,456 | 494,802,228 | 797,627,684 |

Zbatimi: Rekomandimi 7.1 rezulton i zbatuar

Zbatimi: Rekomandimi 7.2 rezulton i zbatuar

Zbatimi: Rekomandimi 7.3 rezulton i zbatuar

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Vorë të marrë masat për të kryer rakordim periodik mujor/3 mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Vorë nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Vorë të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

8.2. Rekomandimi: Grupi i menaxhimit Strategjik të marrë masat e duhura për ndryshimin e Rregullores së Brendshme të institucionit, të miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 214 dhe me nr. 6910 prot., datë 01.12.2022, për përcaktimin e pozicionit të punës së punonjësit të cilit i ngarkohet detyrë ndjekja e arkëtimit nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me ta, duke krijuar një data baze me të dhëna respektivisht nga agjentët.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia Vorë janë mbajtur akt-rakordime për periudha 6- mujore me Drejtorinë Rjonale të Shërbimit të Transportit Rrugor për taksën vjetore të mjeteve të përdorura dhe për periudha mujore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.

Zbatimi: Rekomandimi 8.1 rezulton i zbatuar

Zbatimi: Rekomandimi 8.2 rezulton i pa zbatuar

9.1. Rekomandimi: GMS dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën e të dhënave për administrimin e taksës mbi tokën bujqësore, për të definuar individët, personat fizikë ose juridikë që nënshtrohen taksimit/përjashtimit për këtë kategori taksapaguesish.

9.2. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore/Spektori Familjar, të përditësojnë regjistrat e tokës bujqësore, me ndryshimet e të dhënave sipërfaqeve dhe kategorinë e tokave, për të saktësuar bazën e taksueshme dhe numrin e familjeve objekt i saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se për rekomandimin e mësipërm, Spektori Familjar i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës po përditësojnë të dhënave tokës bujqësore duke saktësuar sipërfaqen dhe kategorinë e tokës dhe duke plotësuar kartela individuale për çdo familjar që disponon tokë bujqësore.

Të gjitha sistemet dhe përditësimet integrohen njëkohësisht në sistemin e integruar të menaxhimit të taksave dhe tarifave vendore.

Zbatimi: Rekomandimi 9.1 rezulton në proces zbatimi

Zbatimi: Rekomandimi 9.2 rezulton në proces zbatimi

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse mbi menaxhimin e detyrimeve të prapambetura ndaj kreditorëve.

10.2. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrë masa në saktësimin e kreditorëve dhe vlerave kreditore pa adresë, ndaj Bashkisë Vorë. Të kryejë kontabilizimin e duhur të Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm, si dhe të vazhdojë me likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se në lidhje me rekomandimin 10.1, është ndërmarrë një analizë e plotë financiare mbi situatën e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Vorë ndaj kreditorëve, evidentimi dhe klasifikimi i detyrimeve të pashlyera sipas furnitorëve, llojit të kontratës dhe vjetërsisë së detyrimit, hartimi i një raporti të detajuar mbi gjendjen aktuale, shkaktarët e vonesave dhe pasojat financiare, Identifikimi i përgjegjësive administrative për vonesat apo mungesën e ndjekjes së rregullt të detyrimeve nga strukturat financiare dhe ekzekutive, përgatitja e një plani të brendshëm shlyerjeje, duke përcaktuar prioritetet dhe burimet buxhetore të disponueshme për zgjidhjen graduale të detyrimeve, krijimi i një mekanizmi monitorimi të brendshëm, për të ndjekur ecurinë e pagesave dhe për të shmangur krijimin e detyrimeve të reja jashtë afateve ligjore.

| Nr. | Përshkrimi | Furnitori | Vlera |
|-----|----------------------------|-----------|--------|
| 1 | Gaz lëng | D. G. | 15,993 |
| 2 | Rërë, Granit, Çimento | A. M. | 73,680 |
| 3 | Materiale | A. M. | 30,390 |
| 4 | Materiale të ndryshme | A. M. | 36,130 |
| 5 | Materiale për ujësjellësin | A. M. | 63,080 |
| 6 | Materiale | A. M. | 11,100 |
| 7 | Karta Vodafoni | L. M. | 25,000 |
| 8 | Materiale të ndryshme | A. M. | 62,600 |
| 9 | Materiale | A. M. | 28,800 |
| 10 | Materiale të ndryshme | A. M. | 37,650 |
| 11 | Kancelari | R. P. T. | 23,320 |

| | | | |
|---------------|--|-----------------|-------------------|
| 12 | Materiale ndërtimi | K. M. | 66,904 |
| 13 | Kancelari | D. K. | 9,100 |
| 14 | Klor | L. 07 SHPK | 24,000 |
| 15 | Çimento | K. - 04 D. | 58,788 |
| 16 | Materiale | A. Gr. SHA B. | 100,020 |
| 17 | Materiale | Mat. E. SHPK T. | 99,936 |
| 18 | Materiale | T. M. | 54,000 |
| 19 | Karburant | C.G. | 90,800 |
| 20 | Karburant | C.G. | 234,000 |
| 21 | Karburant | C. G. | 277,688 |
| 22 | Veshje për Policinë | E. 2."SHPK" | 157,440 |
| 23 | Goma | "U. A." | 80,000 |
| 24 | Materiale ndërtimi | M. M. | 66,800 |
| 25 | Materiale hidraulike | A. D. | 100 |
| 26 | Materiale dezinfektimi | 2 A. SHPK | 330 |
| 27 | Vula | E. P. | 12,000 |
| 28 | Hypoklorit Na | 2-A. SHPK | 42,000 |
| 29 | Karburant | K. SH.A L.14 D. | 360 |
| 30 | Materiale për Shërbimet Publike | A. K. | 6,600 |
| 31 | Materiale për ekipin e futbollit | Sh.K. D. | 463 |
| 32 | Dru zjarri | M.B.K.SHPK L. | 444,002 |
| 33 | Materiale për ujësjellësin | A. K. | 13,290 |
| 34 | Fikëse zjarri | G. SHPK E. | 226,800 |
| 35 | Makineri (Fadrom) | V. SHPK T. | 7,611,836 |
| 36 | Paisje kompjuterike | B. E. T. | 1,356,984 |
| 37 | Vaj + Filter vaji | A.C. Pe L. | 52,560 |
| 38 | Materiale | Sh. e l. m. V. | 11,520 |
| 39 | PAK Janar 2025 | | 10,510,161 |
| 40 | Ndihmë ekonomike Dhjetor 2024 | | 601,258 |
| 41 | Inlaliteti Dhjetor 2024 | | 13,200 |
| 42 | Energji elektrike Dhjetor 2024 | | 816,310 |
| 43 | Uji dhjetor 2024 | | 790,476 |
| 44 | Honorare këshilltare, objekte me qira Dhjetor 2024 | | 918,850 |
| 45 | Objekte me qira Bashkia | | 595,000 |
| Totali | | | 25,751,319 |

-Në lidhje me rekomandimin 10.2, rezulton se në korrik të vitit 2023, Bashkia Vorë ka dërguar një plan për shlyerjen e detyrimeve në Këshillin Bashkiak, i miratuar me vendimin nr. 50, datë 26.07.2023. Ky plan parashikon shlyerjen e detyrimeve deri në fund të vitit 2025, të shpërndarë në tre vite buxhetore si më poshtë:

Për vitin 2023, detyrimi për t'u shlyer është 134,362,554 lekë.

Për vitin 2024, detyrimi për t'u shlyer është 138,339,543 lekë.

Për vitin 2025, detyrimi për t'u shlyer është 140,165,409 lekë.

Kryetari i Bashkisë dhe drejtorët përkatës janë angazhuar maksimalisht për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Gjatë vitit 2024, ata kanë likuiduar të gjitha detyrimet e mbetura për vitin 2023 dhe janë angazhuar që të mbyllin të gjitha detyrimet për vitin 2024 dhe më tej. Gjithashtu, gjatë vitit 2023 nuk janë prokuruar investime të reja për të mos krijuar stok borxhi të ri.

| Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm" | |
|--|--------------------|
| Çelje e vitit 2024 | 363,290,371 |
| Shtesa | |
| Pakësime | 209,532,527 |
| Gjendja në 31.12.2024 | 153,757,844 |

Zbatimi: Rekomandimi 10.1 rezulton i zbatuar

Zbatimi: Rekomandimi 10.2 rezulton i zbatuar

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse në lidhje me pajisjen me certifikatë pronësie të pasurive të transferuara me VKM.

Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Bashkinë Vorë, të marrë masa të menjëhershme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të pasurive pa certifikatë pronësie dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjërë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Kryetari i Bashkisë ka urdhëruar fillimin e analizës për situatën aktuale të pasurive të transferuara me VKM që ende nuk janë pajisur me certifikatë pronësie. Është hartuar një raport i brendshëm analitik, ku janë identifikuar, pasuritë e regjistruara, pasuritë e paregjistruara, shkaqet e mosregjistrimit dhe pengesat ligjore/administrative, Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës ka nisur përgatitjen e dosjeve për regjistrim në ASHK, sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi (Ligji nr. 20/2020, VKM përkatëse të transferimit, udhëzime të MIE dhe ASHK). Pronat e certifikuara janë sipas tabelës më poshtë.

| Nr. | | VKM | | | Në pronësi në numër | Në përdorim në numër | Prona në varësi të Pushtetit Qëndror | Nga këto regjistruar |
|-----|----------------|------|------------|-------------------|---------------------|----------------------|--------------------------------------|----------------------|
| | | Nr. | Datë | Nr. pronave Total | | | | |
| 1 | Bashkia (Vorë) | 502 | 19.07.2006 | 524 | 177 | 80 | 267 | |
| | | 607 | 12.09.2007 | 524 | 177 | 80 | 267 | |
| | | 577 | 28.05.2009 | 448 | 177 | 80 | 191 | 98 |
| 2 | | 134 | 03.03.2021 | 107 | 107 | | | 12 |
| 3 | | 1108 | 30.12.2015 | 23 | 23 | | | 2 |
| 4 | NJA Prezë | 792 | 16.11.2011 | 317 | 185 | 5 | 127 | 8 |
| 5 | NJA Bexull | 667 | 11.06.2009 | 96 | 84 | 8 | 4 | 1 |
| 4 | | | | | | | | |

Zbatimi: Rekomandimi 11.1 rezulton në proces zbatimi

12.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse në lidhje me gjendjen reale të pasurisë “troje” në sistemin financiar të institucionit. Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të marrë masa për plotësimin dhe dorëzimin e të gjithë praktikave të pronave të certifikuara, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, në përputhje me legjisllacionin, për të pasur informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës ka ndërmarrë, verifikimin dhe përditësimin e të dhënave mbi pasuritë “troje” të pajisura me certifikatë pronësie, përgatitjen e dosjeve për secilën pasuri të certifikuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat publike” dhe ligjit për kontabilitetin, Dorëzimin e dokumentacionit të plotë në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, për regjistrim dhe pasqyrim korrekt në sistemin financiar. Drejtoria e Menaxhimit Financiar ka evidentuar dhe përditësuar në regjistrat kontabël pasuritë “troje” në përputhje me dokumentacionin ligjor të dorëzuar, përmirësuar informacionin kontabël në pasqyrat financiare.

| Bashkia | Nj. A | VKM | Sasia Total | Pronësi | Përdorim | Prona në varësi të pushtetit qëndror | Certifikuar | Inventarizuar | Vlerësuar | Kontabilizuar | Prona të zaptuara | Prona në proces legalizimi |
|---------|-------|-----------------|-------------|---------|----------|--------------------------------------|-------------|---------------|-----------|---------------|-------------------|----------------------------|
| Vorë | | 134, 03.03.2021 | 107 | 107 | | | 12 | | | | | |
| Vorë | Vorë | 577, 28.05.2009 | 448 | 177 | 80 | 191 | 98 | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|------|---------|---------------------|-----|-----|---|-----|---|--|--|--|---|
| Vorë | | 1108, 30.12.2015 | 23 | 23 | | | 2 | | | | |
| Vorë | Prezë | 792, 16.11.2011 | 317 | 185 | 5 | 127 | 8 | | | | |
| Vorë | Bërxull | 667, 11.06.2009 | 96 | 84 | 8 | 4 | 1 | | | | 1 |

Zbatimi: Rekomandimi 12.1 rezulton në proces zbatimi

13.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vorë të paraqesë për miratim në Këshillin Bashkiak, numrin e punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Vorë të marrë masa për zbatimin me korrektësi të strukturës së miratuar nga Kryetari Bashkisë, për çdo vit buxhetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Kryetari i Bashkisë Vorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë e Buxhetit, ka hartuar propozimin zyrtar për numrin e punonjësve buxhetorë, të ndarë sipas njësive shpenzuese, funksioneve dhe pozicioneve të miratuara, struktura organizative e miratuar për vitin buxhetor 2025. Ky propozim është paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak dhe është miratuar me vendim nr. 69 datë 22.12.2023 “Miratimi i buxhetit për vitin 2024” dhe Vendimi nr. 44 datë 16.09.2024 “Miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Vorë ne bazë të organigramës.

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka ndjekur: zbatimin e strukturës së miratuar, duke respektuar kufijtë buxhetore dhe numrin e miratuar të punonjësve, ndjekjen e çdo lëvizjeje personeli në përputhje me aktet përkatëse nënligjore (Ligji nr. 152/2013, VKM dhe udhëzime të DAP-it), përgatitjen e pasqyrave periodike për zbatimin e strukturës dhe monitorimin e saj gjatë vitit buxhetor 2024.

Zbatimi: Rekomandimi 13.1 rezulton i zbatuar

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik për një menaxhim të sigurt dhe efikas të të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë, të marrë masa për kalimin në sisteme të avancuara dhe të integruara informatike, të cilët do të rrisin efikasitetin në menaxhim dhe kontrollin e brendshëm.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se në kuadër të zbatimit të këtij rekomandimi, janë ndërmarrë këto hapa konkretë: Grupi i Menaxhimit Strategjik, në bashkëpunim me strukturat përkatëse teknike dhe financiare, ka realizuar një vlerësim të gjendjes ekzistuese të sistemeve informatike në përdorim për menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

1. Është hartuar një plan veprimi për dixhitalizimin dhe integrimin e sistemeve, me qëllim, rritjen e transparencës, aksesit dhe sigurisë së të dhënave financiare, automatizimin e procesit të raportimit financiar dhe menaxhimit të fondeve, rritjen e kapaciteteve për kontrollin e brendshëm në kohë reale.
2. Bashkia Vorë është në proces bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe institucione të tjera përkatëse, migrimin drejt sistemeve të integruara të menaxhimit financiar dhe buxhetit, trajnimin e stafit për përdorimin e moduleve të reja informatike, sigurimin e infrastrukturës teknologjike dhe IT në nivel bashkie.

3. Janë përfshirë kostot për përmirësimin e sistemeve IT në buxhetin e vitit 2025, si dhe janë parashikuar fondet për mirëmbajtje dhe trajnime.

Zbatimi: Rekomandimi 14.1 **rezulton i zbatuar**

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë të marrë masa për përmirësimin e marrëdhënies ndërmjet institucionit me komunitetin dhe biznesin, për njoftimin e tatimpaguesve për tarifa dhe taksa vendore, duke zëvendësuar njoftimin dorazi me njoftimin me postë ose me metoda bashkëkohore të komunikimit.

Njoftimet duhet të jenë të qarta, të sakta, si dhe të dërgohen në kohë për të ofruar mundësi të ndryshme në kryerjen e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është implementuar sistemi i integruar i menaxhimit të taksave dhe tarifave vendore, nëpërmjet së cilit mundësohet njoftimi i taksapaguesve nëpërmjet postës elektronike. Njoftim-vlerësimet janë formatizuar në mënyrë sa më të qartë dhe të lexueshme nga ana e subjekteve.

Zbatimi: Rekomandimi 15.1 **rezulton i zbatuar**

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe Nëpunësi Zbatues i institucionit, të marrin masa që gjatë procedurave të inventarizimit, qarkullimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve, të ndiqen të gjithë hapat sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor, me qëllim dokumentimin e gjurmës së auditimit dhe menaxhimin me efektivitet të tyre.

Në vijimësi

16.2. Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të marrë masa për krijimin e regjistrat fizik të asetëve, me të gjithë komponentët e duhur sipas kuadrit ligjor dhe të miratohet nga Kryetari i Bashkisë Vorë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se në zbatim të rekomandimit 16.1, janë ndërmarrë këto veprime konkrete:

1. Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhër të brendshëm për rishikimin dhe forcimin e procedurave të brendshme për administrimin e aktiveve materiale, në përputhje me:
 - o Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,
 - o Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,
 - o Udhëzimin nr. 26, datë 4.11.2008 (i ndryshuar), mbi inventarizimin e pasurive.
2. Është ngritur një komision i posaçëm inventarizimi nr. 190 datë 07.11.2024 dhe janë përditësuar afatet dhe format standarde për Inventarizimin fizik të aktiveve të Bashkisë Vorë për vitin 2024, si dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të dëmtuara, jashtë funksioni ose të amortizuara. Është bërë ngritja e komisionit të vlerësimit të aktiveve nr. 202 datë 27.12.2024 dhe asgjesimi i tyre në bazë të urdhërit nr. 203 datë 30.12.2024.
3. Është siguruar dokumentimi i plotë i çdo veprimi mbi asetet (procesverbale, vendime, kërkesa transferimi, propozime për nxjerrje nga përdorimi), për të garantuar një gjurmë të qartë auditimi dhe verifikim të mëvonshëm.

-Në lidhje me rekomandimin 16.2, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe sektori i aktiveve kanë përmirësuar regjistrat në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore për administrimin dhe kontrollin e pasurive publike, duke u bazuar në: Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë

publike”; Udhëzimin nr. 26, datë 04.11.2008 (i ndryshuar), për inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive; Udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Regjistri fizik përfshin: Emërtimin e pasurisë; Vendndodhjen (adresa dhe koordinatat kadastrale); Statusin juridik (i regjistruar / në proces regjistrimi); Vlerën kontabël dhe përshkrimin fizik të pasurisë; Numrin e vendimit / aktit të transferimit ose certifikatës së pronësisë; Përgjegjësinë e përdorimit dhe administrimit. Paralelisht është bërë regjistri fizik dhe ai elektronik, për të garantuar ruajtjen, përditësimin dhe aksesin e strukturuar të të dhënave.

Zbatimi: Rekomandimi 16.1 rezulton **i zbatuar**

Zbatimi: Rekomandimi 16.2 rezulton **i zbatuar**

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrë masa në plotësimin e të gjitha rubrikave dhe shënimeve në pasqyrat financiare, për të dhënë një pamje të përgjithshme e të plotë të tyre, në zbatim të kuadrit ligjor.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit ka realizuar përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore në përputhje të plotë me kërkesat e pikës 116 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”. Pasqyrat janë hartuar në mënyrë të unifikuar dhe përfshijnë: Pasqyrën e pozicionit financiar (Bilancin), Pasqyrën e performancës financiare (të ardhurat dhe shpenzimet), Pasqyrën e flukseve monetare, Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare, Pasqyrën statistikore të investimeve dhe burimeve të financimit të tyre, Pasqyrën statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata sipas kostos historike dhe vlerës neto, si dhe pasqyrën statistikore të numrit të punonjësve dhe fondit të pagave.

Zbatimi: Rekomandimi 17.1 rezulton **i zbatuar**

18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa në përditësimin dhe forcimin e aktivitetit të GMS, në mënyrë që GMS të ofrojë mbështetje dhe këshilla për vetë titullarin, si dhe të marrë masa për hartimin dhe miratimin e raporteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Kryetari i Bashkisë, ka nxjerrë urdhrin nr. 02 datë 27.12.2023 për Ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik dhe urdhrin nr. 47 datë 04.04.2024, të ekipeve të menaxhimit të programeve EMP. Rifunksionalizimin e GMS, duke përfshirë përfaqësues nga drejtoritë më të rëndësishme dhe sektorët teknikë; Mbledhje periodike të GMS me procesverbale të dokumentuara; Përcaktimin e rolit këshillues të GMS ndaj Kryetarit të Bashkisë për çështje që lidhen me strategjinë institucionale, menaxhimin e burimeve dhe riskun operativ. Janë hartuar dhe miratuar raporte periodike (mujorë dhe tremujorë), të cilët përfshijnë: Vlerësimin e performancës së brendshme; identifikimin e risqeve kryesore dhe masat për përballimin e tyre.

Zbatimi: Rekomandimi 18.1 rezulton **i zbatuar**

19.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vorë të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante të strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm me auditues të kualifikuar dhe me përvojë, me qëllim përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave të kësaj njësie.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Drejtoria e Burimeve Njerëzore me vendimin nr. 109 prot., datë 01.03.2024 ka shpallur procedurën për kategorinë e mesme dhe ulët drejtuese ku është shpallur dhe pozicioni i përgjegjës të Auditit të Brendshëm bazuar në ligjin 152/2013. Shpallja e pozicionit është bërë me shkresën nr. 1143 prot., datë 01.03.2024, shpallje kjo që i është njoftuar për publikim Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Tiranë. Me shkresën nr. 1387/2 prot., datë 13.03.2024 është njoftuar AKPA që për pozicionin e Përgjegjës të Auditit të Brendshëm për procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë nuk ka pasur kandidatë. Me njoftimin për publikim nr. 1436 prot., datë 18.03.2024 drejtuar AKPA është njoftuar që kjo procedurë mbyllet pa kandidatë për pozicionin e Përgjegjës të Auditit të Brendshëm.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore ka ndërmarrë të gjitha hapat ligjore për plotësimin e kësaj vakance dhe këtij rekomandimi.

Zbatimi: Rekomandimi 19.1 **rezulton në proces zbatimi**

20. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vorë nuk ka përgatitur informacionin përkatës lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”. Nga auditimi u konstatua, mungesë e gjurmës së raportimit në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 4 dhe 5, të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve dërguar nga KLSH me shkresën nr. 520/10 prot., datë 18.12.2023, janë lënë për zbatim 67 rekomandime nga të cilat:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 28 masa organizative, pranuar plotësisht, nga të cilat 7 masa janë zbatuar plotësisht, 18 masa në proces zbatimi dhe 3 masa nuk janë zbatuar.

b. Masa për shpërbllim dëmi 1 rekomandim për kërkimin në rrugë ligjore duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës 204,672 lekë, pranuar plotësisht dhe kanë ecurinë 1 rekomandim pa zbatuar.

c. Masa për uljen e detyrimit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), janë lënë 5 rekomandime në shumën 358,226 mijë lekë, të pranuar plotësisht dhe kanë ecurinë 4 masa në proces zbatimi, dhe 1 rekomandim pa zbatuar.

d. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike, janë lënë 2 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht, dhe të 2 masat janë pa zbatuar.

e. 29 masa disiplinore, të pranuar dhe 29 rekomandime të zbatuar plotësisht.

f. Njoftimi Departamentin të Administratës Publike dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, 1 masë rezultoi e pa zbatuar.

g. 1 masë administrative për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj Operatorit Ekonomik “D.” ShPK, përfaqësuar nga administratori z. V. T. pa zbatuar.

20.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, si dhe të marrë masat e nevojshme për zbatimin e masave pjesërisht të realizuara, të pa zbatuara dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe forcimin e disiplinës buxhetore dhe fiskale.

Menjërherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm është në proces zbatimi.

Zbatimi: Rekomandimi 20.1 rezulton në proces zbatimi

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË TË ARDHURAT E MUNGUARA NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, DHE NË MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE

1.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Vorë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të pa kontabilizuara për tarifa dhe taksa vendore, të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimeve të pashlyera debitorë familjarë për vlerën 11,923,215 lekë, të nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrimet e papaguara tatimore, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët për arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se bazuar në urdhrin nr. 30 datë, 24.02.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vorë, për regjistrimin në kontabilitet të listës së debitorëve për taksat dhe tarifave vendore është dërguar për kontabilizim pranë Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit, lista e debitorëve të Kategorisë Familjare, me shkresën nr. 179 prot., datë 17.03.2025.

Për të gjithë subjektet debitorë të kategorisë Familjare është dërguar Njoftim vlerësimi për detyrimet e papaguara në rrugë postare.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 rezulton në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Bashkia Vorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e tokës bujqësore në vlerën 1,077,599 lekë.

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të urdhërojë ngritjen e komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore për verifikim e vërtetësisë së vetdeklarimit të sipërfaqes së tokës bujqësore të dorëzuar nga subjekti tatimpagues.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se mbështetur në urdhrin nr. 1811 prot., datë 11.04.2025 dhe në zbatim të rekomandimit 9.2, Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, po kryhet proces i detajuar i kartelave për çdo fshat, përmes verifikimit individual të secilës kartelë me qëllim përditësimin e të dhënave në kartelat e tokës bujqësore.

Ky proces është në vijim e sipër, po punohet për rishikimin dhe përmirësimin e regjistrave ekzistues, me fokus në saktësimin e sipërfaqeve, në funksion të përcaktimit të bazës së taksueshme për çdo njësi familjare.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 rezulton i pa zbatuar

Zbatimi: Rekomandimi 2.2 rezulton i në proces zbatimi

3.1. Rekomandimi: Bashkia Vorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të pa leje në vlerën 2,892,273 lekë.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të regjistrojë në kontabilitet detyrimet e pashlyera nga subjekte taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 2,892,273 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se në lidhje me rekomandimin 3.1, Bashkia Vorë ka marrë të gjitha masat dhe nga vlera 2,892,273 lekë, ka arkëtuar 2,255,442 lekë, për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

-Në lidhje me rekomandimin 3.2 rezulton se Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në zbatim të Urdhrit të Kryetarit nr. 30, datë 24.02.2025, për regjistrimin në kontabilitet të listës së debitorëve për Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë, ka dërguar pranë Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore listën e debitorëve të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për ndërtimet pa leje për ti kontabilizuar në bilanc detyrimet e pashlyera të individëve dhe subjekteve fizikë dhe juridike.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 rezulton në proces zbatimi

Zbatimi: Rekomandimi 3.2 rezulton i zbatuar

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marri masa për arkëtimin e detyrimeve të pa kontabilizuara për tarifa e pastrimit në vlerë 7,397,258 lekë, duke nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrimet e papaguara tatimore, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve të pa kontabilizura për tarifa dhe taksat vendore.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të regjistrojë në kontabilitet detyrimet e pashlyera nga “Tarifa e Pastrimit” nga subjekte fizike, juridike dhe familjare në vlerë 18,305,705 lekë, duke nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrimet e papaguara tatimore, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve të pa kontabilizura për tarifa dhe taksat vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se bazuar në urdhrin nr. 30 datë, 24.02.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vorë, për regjistrimin në kontabilitet të listës së debitorëve për taksat dhe tarifat vendore, është dërguar për kontabilizim pranë Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Programeve të strehimit, lista e debitorëve të subjekteve të Biznesit të Madh, Biznesit të Vogël dhe Kategorisë Familjare, me shkresat nr. 179 prot., datë 17.03.2025 dhe nr. 147 prot., datë 27.03.2025.

Për të gjithë subjektet debitorë është dërguar Njoftim vlerësimi për detyrimet e papaguara në rrugë postare dhe elektronike.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 rezulton i zbatuar

Zbatimi: Rekomandimi 4.2 rezulton i zbatuar

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për kontabilizimin e detyrimit, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur 2,300,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë marrë të gjitha masat administrative për arkëtimin e vlerës debitorë nga autorizimet për tregëtimin e karburanteve. Nga 2,300,000 lekë, të vlerës së debisë, janë arkëtuar 1,700,000 lekë.

Vlera e pa arkëtuar prej 600,000 lekë i përket subjektit B. T. i cili ka lidhur akt marrëveshje me Bashkinë Vorë për likuidim me këste të detyrimit, nga ku i cili do të paguajë 200,000 lekë / vit.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 rezulton në proces zbatimi

D. MASA PËR ULJEN E DETYRIMEVE TË PAPAGUARA TATIMORE DHE RRRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1.1. Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrë masa për rakordimin e stokut të detyrimeve të papaguara për të gjitha strukturat e Bashkisë Vorë.

1.2. Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrë masa për uljen e stokut të detyrimeve të papaguara, nga mos pagesa e tarifave dhe taksave vendore nga subjekte fizike, juridike dhe familjare, në vlerën 376,288,910 lekë, të krijuar deri 31.12.2023, duke aplikuar në mënyrë shteruese masa shtrënguese të tilla, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, si dhe rritur informimin dhe sensibilizimit publik mbi pagesën e tyre në dobi të komunitetit.

1.3. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe drejtoritë e tjera që administrojnë të ardhura vendore, të marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pashlyera nga të ardhurat vendore, të krijuara nga 01.01.2023 - 31.12.2023, në shumën 46,244,026 lekë dhe raportimin e stokut të trashëguar për detyrimet e prapambetura që i përkasin periudhës 2004 - 2020 në shumën 27,219,428 lekë, në total 73,463,454 lekë.

1.4. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kriterëve ligjore për sistemimin e vlerave debitore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë marë këto masa:

1. Janë dërguar dhe ridërguar urdhra Bllokimi në të gjitha Bankat e nivelit të dytë për çdo subjekt debitor, bazuar në nenin 90 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", me shkresat nr. 13 prot., datë 29.02.20254 dhe nr. 16 prot., datë 01.03.2024.
2. Është dërguar "*Njoftim për Vendosjen e Barrës Siguruese*" Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimit Transportit Rrugore, bazuar në nenin 91 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", me shkresën nr. 20 prot., datë 01.03.2025.
3. Është dërguar "*Njoftim për Vendosjen e Barrës Hipotekore*" Zyrës Qëndrore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjensisë së Kadastrës Fiskale, bazuar në nenin 91 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimor*, me shkresën nr. 19 prot., datë 01.03.2025.
4. Njoftime për të gjithë subjektet debitore "*Kërkesë për pagesën e detyrimeve të papaguara*" me datë 14.08.2024.
5. Bllokim i veprimtarive tregtare për subjektet debitore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake

-Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë marë këto masa:

Bazuar në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Vorë nr. 30 datë, 24.02.2024, "*Për regjistrimin në kontabilitet të listës së debitorëve për taksat dhe tarifat vendore*", është dërguar për kontabilizim pranë Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit, lista e debitorëve të

subjekteve të Biznesit të Madh, Biznesit të Vogël dhe Kategorisë Familjare, me shkresat nr. 179 prot., datë 17.03.2025 dhe nr. 147 prot., datë 27.03.2025.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 rezulton **i zbatuar**

Zbatimi: Rekomandimi 1.2 rezulton **i zbatuar**

Zbatimi: Rekomandimi 1.3 rezulton **në proces zbatimi**

Zbatimi: Rekomandimi 1.4 rezulton **i zbatuar**

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik në Bashkinë Vorë, të marrin masa në ndjekjen e të gjitha hapave administrative e ligjore, për të arkëtuar vlerën prej 7,921,949 lekë nga subjekti debitor “A-D” SHPK, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9396, datë 12.05.2005, “Për qiratë financiare”, i ndryshuar, neni 28 e vijues, me procedurat si vijon:

- a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare;
- b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit;
- d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare, subjekti nuk paguan detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim-Taksave të merren masa administrative, deri në sekuestro;
- e. Të bashkërendojnë punën me Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);
- f. T’i drejtohet gjykatës kompetente për zgjidhje të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë marë këto masa:

1. Ka dërguar dhe ridërguar urdhër bllokimi në të gjitha Bankat e nivelit të dytë për çdo subjekt debitor, bazuar në nenin 90 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me shkresat nr. 13 prot., datë 29.02.20254 dhe nr. 16 prot., datë 01.03.2024.
2. Ka dërguar "Njoftim për Vendosjen e Barrës Siguroese" Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimit Transportit Rrugore, bazuar në nenin 91 të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me shkresën nr. 20 prot., datë 01.03.2025.
3. Ka dërguar "Njoftim për Vendosjen e Barrës Hipotekore" Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjensisë së Kadastrës Fiskale, bazuar në nenin 91 të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me shkresën nr. 19 prot., datë 01.03.2025.
4. Ka dërguar njoftim "Kërkesë për pagesën e detyrimeve të papaguara" me datë 14.08.2024.
5. Është mbajtur procesverbal Konstatimi në terren nga ana e specialistëve për verifikimin e mbylljes së aktivitetit.
6. Kërkesë për bashkëpunim drejtuar Drejtorisë së Çështjeve Ligjore për sqarimin e situatës së vlefshmërisë së kontratës nga e cila lind debia.

Drejtoria e Çështjeve Ligjore, sipas Memos me nr. 170 prot., datë 10.01.2025 ka zgjidhur kontratën ndërmjet Bashkisë Vorë dhe subjektit A.-D..

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 rezulton **i zbatuar**

E. MASA DISIPLINORE

E.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

E.1.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa “c”; Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”; në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vorë dhe Komisionit Disiplinor të kërkojnë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58, germa “c” për nëpunësit e mëposhtëm:

1. Për znj. A.D., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe me cilësinë e autorizuar si NZ, nga data 23.08.2023 e në vazhdim.

- Për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, sipas përcaktimeve në Ligjin organik të buxhetit të shtetit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin vjetor “Për buxhetin e shtetit”, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit;

- Në mos kryerjen e klasifikimit të saktë të aktiveve si dhe sistemimin e vlerave me kosto historike së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogaritur, në kundërshtim me pikat nr. 2, 10 dhe 21 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, i përmirësuar. Si dhe me kapitullin III, të udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.

- Për mos marrjen e masave në kontabilizimin e të gjithë vlerave debitore të trashëguara në vite;

- Në mos marrjen e masave gjatë procedurave të inventarizimit, qarkullimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor me qëllim dokumentimin e gjurmës së auditimit dhe menaxhimin me efektivitet të tyre në kundërshtim me nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit zbatues” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Me paragrafin nr. 82, nr. 95 dhe 109 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë Publike”, i ndryshuar.

2. Z. G. D., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

- Për mos dërgimin e detyrimeve të papaguara për kontabilizim, nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë, për Bashkinë Vorë në vlerën 1,226,188 lekë, për Njësinë Administrative Bërxullë në vlerën 1,141,617 lekë dhe për Njësinë Administrative Prezë në vlerën 524,469 lekë, në total 2,892,273 lekë, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vorë, në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22.

- Për mos marrjen e masave dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në vlerën 1,077,599 lekë dhe në arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 2,892,273 lekë.

3. Z. I. D. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

- Për mos marrjen e masave në përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të pasurive pa certifikatë pronësie, me qëllim pajisjen e pasurive të paluajtshme me titull pronësie;

- Për mos krijimin e regjistrit fizik të asetëve, me të gjithë komponentët e duhur, sipas kuadrit ligjor;

- Për mos plotësimin dhe dorëzimin në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, e të gjithë praktikave të pronave të certifikuara, në përputhje me legjislacionin, në kundërshtim me nenin 37, të Ligjit nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe me nenin 122-125 *“Detyrat dhe Përgjegjësitë”* e Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

4. Znj. M. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit, nga data 01.01.2023 deri në 08.08.2023.

- Për mos zbatimin me korrektësi të strukturës së miratuar nga Kryetari Bashkisë, për çdo vit buxhetor;

- Për mos hartimin e programeve të trajnimeve për punonjësit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës së institucionit si dhe vlerësimin periodik të nevojave për trajnimin e stafit në lidhje me zbatimin e instrumenteve të kontrollit të brendshëm.

5. Znj. A. H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit, nga data 08.08.2023 e në vazhdim.

- Për mos hartimin e programeve të trajnimeve për punonjësit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës së institucionit si dhe vlerësimin periodik të nevojave për trajnimin e stafit në lidhje me zbatimin e instrumenteve të kontrollit të brendshëm.

6. Z. A. L. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Biznesit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Për mos zbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në evidentimin e plotë të debitorëve të biznesit të madh e të vogël, krijuar në vitin 2023, si dhe mos dërgimin për kontabilizim në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar. Veprime në kundërshtim me nenin 23 *“Përgjegjësitë”*, të Ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, si dhe me nenet 71-75, *“Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”*, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

7. Znj. K. O. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Familjar, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Për mos zbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në evidentimin e listës së debitorëve kategoria familjarë, të mbartura dhe krijuar gjatë vitit 2023, nga taksa e ndërtesës, nga taksa e tokës bujqësore, nga tarifa e pastrimit, si dhe mos dërgimin për kontabilizim në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* neni 22; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar, neni nr. 4; Ligjin nr. 68/2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”* neni 12; VKB 70/2022 *“Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”* pika 3.2, si dhe me nenet 71-75, *“Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”*, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

8. M. D. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Statistikave dhe Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Për mos zbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga taksat e tarifave vendore, veprime në kundërshtim me

kërkesat e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI, si dhe me nenet 71-75, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

“Vërejtje” neni 58, germa “a” për nëpunësit e mëposhtëm:

1. Znj. L. S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Buxhetit, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar.

- Për moszbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në planifikimin e buxhetit të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025, sipas përcaktimeve në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin vjetor “Për buxhetin e shtetit”, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit; nenet 49-50, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

2. Z. D. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar.

- Për moszbatimin e detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë në monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025, sipas përcaktimeve në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin vjetor “Për buxhetin e shtetit”, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit; nenet 49-50, “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave”, të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë.

E.1.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vorë që, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

“Vërejtje”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. E. E., me detyrë zv/Kryetar i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Kryetarit të komisionit të asgjësimit të aktiveve për vitin 2023.

- Për mos dokumentimin e procedurës së ndjekur dhe gjurmën e auditimit për riciklimin, grosposjen apo djegien e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Veprim ky në kundërshtim me pikën nr. 109, 118 dhe 121 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, të ndryshuar.

2. Znj. E. M., me detyrë Administrator i Njësisë Prezë, në cilësinë e Kryetarit të komisionit të inventarizimit të aktiveve të vitit 2023.

- Për mos zbatimin e saktë të procedurave në inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të Njësisë Administrative Prezë, pasi ka nënshkruar në cilësinë e kryetarit të komisionit të inventarizimit dhe njëkohësisht edhe si përgjegjës i materialeve në këtë njësi. Veprim ky në kundërshtim me

paragrafin nr. 82, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë Publike”, i ndryshuar.

Komenti i Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Kryetari i Bashkisë Vorë është nxjerrë urdhri nr. 25, me nr. 1611 prot., datë 28.03.2025 për ngritjen e komisionit disiplinor dhe shqyrtimin e procedurave me qëllim evidentimin e përgjegjësive për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore. Për zbatimin e rekomandimit të mësipërm administrohet dokumentacioni mbi punën e bërë nga komisioni disiplinor.

Zbatimi: Rekomandimi **rezulton i zbatuar**

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Rregullores, për shkak të mosplotësimit të afatit 6 mujor për zbatimin e rekomandimeve, nuk është e mundur të jepet një rekomandim në këtë fazë.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, për periudhën objekt auditimi, janë konstatuar disa mangësi si vijon:

- Mungon plani vjetor i trajnimeve të detyrueshme për punonjësit dhe programe të trajnimit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës,
- Dosjet e personelit nuk janë të rregullta pasi për punonjësit me Kod Pune nuk administrohet rregullisht vlerësimi periodik 1 vjeçar;
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm;
- Nuk janë zhvilluar në mënyrë periodike takimet e GMS;
- Nuk janë miratuar manualët e proceseve të punës;
- Nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse, nuk është miratuar një rregullore e brendshme IT, nuk ka rregullore për sigurinë e informacionit, nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it, plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Mangësitë më sipër janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm konkretisht Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika c, Kreu III, neni 20, neni 22, pika 1; neni 23, neni 24, pika 1, Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, nenin 12, 13. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-24, të Projekt Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit, plotësimin rregullisht të dosjeve të personelit, ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, realizimin në mënyrë periodike të takimeve të GMS, miratimin e manualeve të proceseve të punës, ngritjen e sistemeve funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse, miratimin e një rregullore të brendshme IT dhe sigurinë e informacionit, miratimin e procedurave të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it, planit për menaxhimin e riskut IT si dhe për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm evidentohet se me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 120, datë 30.11.2023, nr. 6604 prot., “Mbi miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërxull për vitin 2024”, sektori do të përbëhej nga 4 punonjës, konkretisht 1 (një) përgjegjës dhe 3 (tre) specialistë. Konstatohet se për vitin 2024, kjo strukturë ka vepruar vetëm me 2 (dy) punonjës në pozicionin specialist. Pra, struktura ka qenë e paplotësuar, si rrjedhojë e mos pasjes së një përgjegjësi për gjatë gjithë vitit, si dhe të një specialisti tjetër. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik, pika 3 dhe me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 24-28 të Projekt Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për plotësimin e strukturës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm me dy pozicionet të cilat rezultojnë vakante, me qëllim përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave të kësaj njësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Auditit të Brendshëm u evidentua se nuk janë zbatuar me rigozitet afatet procedurale në zbatimin e auditimit, konkretisht afati 10 ditor i njoftimit për takimin fillestar, në auditimet e ushtruara në “Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimi të Territorit (DPKZHT)” dhe në “Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit”. Grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion Vendimi “Për programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Bashkinë Vorë” për vitin 2024.

Në raportin për zbatimin e rekomandimeve nuk është plotësuar tabela nr. 1 dhe 2 siç parashikohet në Udhëzimin nr. 42 datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, pika 14.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 24-28, të Projekt Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Sektori i Auditit të Brendshëm të marrë masa për të zbatuar me rigozitet afatet procedurale gjatë kryerjes së procedurave të auditimit. Gjithashtu në hartimin e raportit të zbatimit të rekomandimeve, të marrin masa për të plotësuar tabelat e përcaktuara me informacionet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale paraqitet në bilanc me vlerën 237,904 mijë lekë, e cila përputhet me pasqyrën e amortizimit të bilancit, por nga shqyrtimi i tij u konstatua se llogaritja e amortizimit është kryer në mënyrë të grupuar sipas natyrës së aktiveve dhe jo në mënyrë individuale për secilin aktiv, duke bërë të pamundur identifikimin dhe vlerësimin e vlerës neto kontabël të çdo aktivi në mënyrë individuale, me pasojë cenimin e transparencës, besueshmërisë dhe krahasueshmërisë së të dhënave financiare. Kjo mënyrë e llogaritjes nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-45, të Projekt Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të sigurojë që llogaritja e amortizimit të kryhet në mënyrë individuale për çdo aktiv afatgjatë, si dhe të përmirësohet evidenca kontabël e aktiveve në mënyrë që në pasqyrat financiare të jetë e qartë dhe e verifikueshme vlera neto kontabël e secilit aktiv, duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e informacionit financiar.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, u konstatua se në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 rezulton në vlerën 168,208 mijë lekë, ndërsa në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 363,290 mijë lekë, me një ulje prej 195,083 mijë lekë, e cila reflekton shlyerjen e një pjese të detyrimeve ndaj kreditorëve të ndryshëm. Në këtë llogari rezulton se janë shtuar vlera të mbartura që datojnë që nga viti 2006, të cilat fillimisht ishin regjistruar në llogaritë 401-408 “Furnitorë të ndryshëm” dhe i përkasin furnizimeve të vjetra apo diferencave në faturim. Një pjesë e këtyre detyrimeve rezulton e papagueshme. Mungesa e analizës dhe rivlerësimit të këtyre detyrimeve mbart riskun e mos pasqyrimit me besueshmëri të pozicionit real të detyrimeve të institucionit. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kapitulli III, pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-45, të Projekt Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të kryejë një analizë të detajuar të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, me qëllim identifikimin e detyrimeve reale të pagueshme dhe atyre të papagueshme, si dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme kontabël për mbylljen, rivlerësimin ose riklasifikimin e tyre. Gjithashtu, të sigurohet që pasqyrat financiare të pasqyrojnë në mënyrë të saktë dhe transparente gjendjen reale të detyrimeve, duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor dhe standardeve të kontabilitetit publik.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të vitit 2024, gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet me vlerë 0 lekë. Nga shqyrtimi u konstatua se në këtë llogari nuk është pasqyruar pjesëmarrja e Bashkisë Vorë, si ortak i vetëm i K. F. V. SH.A., në vlerën 2,000 mijë lekë. Mosregjistrimi i kësaj vlere cënon saktësinë dhe plotësinë e pasqyrimit të aktiveve financiare dhe të fondit bazë të institucionit. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, pika 31, gërma a, në momentin fillestar të pjesëmarrjes me kapital, njësi të qeverisjes së përgjithshme duhet të kryejnë regjistrimin kontabël përkatës duke debituar llogarinë 26 “Pjesëmarrja me kapitalin e vet” dhe kredituar llogarinë 1011 “Shtesa të fondit bazë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-45, të Projekt Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa që pjesëmarrja e Bashkisë Vorë në kapitalin e K. F. V. SH.A, në vlerën 2,000 mijë lekë, të pasqyrohet saktësisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, duke reflektuar në mënyrë të besueshme dhe transparente pozicionin financiar të njësisë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh për taksat dhe tarifatat vendore, ku në fund të vitit 2023 vlera e debitorëve është 302,825 mijë lekë, shtesat gjatë vitit 2024 janë në shumën 423,203 mijë lekë. Detyrimet progresive në fund të vitit 2024 janë në shumën 726,028 mijë lekë, e cila përbëhet nga:

- Detyrimet debitorë nga biznesit i madh dhe i vogël në shumën 332,943 mijë lekë.
- Detyrimet debitorë nga familjarët në shumën 393,085 mijë lekë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9632 datë 30.01.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe VKB nr. 16 datë 25.03.2024 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesa të paketës fiskale të vitit 2024.” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-45, të Projekt Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave, të analizojnë situatën debitorë dhe të hartojnë një plan masash periodike dhe vjetor për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB për të parandaluar krijimin e debitorëve të rinj.

Të merren masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, masat shtrënguese dhe bllokimet e llogarive, për rritjen e arkëtimeve të debitorëve me qëllim minimizimin e vlerës progresive të debisë prej 797,628 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

C. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vorë**, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT